



100 Vjet
MEDRESEJA E TIRANËS
(1924 - 2024)



Revista Drita Islame në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

BOTA JONË

REFLEKSIONE

TRASHËGIMI KULTURORE

FAMILJA

PERSONALITETE



www.dritaislame.al

“Drita islame”
Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

DREJTOR
Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR
Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA
Erzen Carja

KONTAKT:
Tel/fax 04 223 04 092
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXXIII i botimit
Nr. 12 (499)
Dhjetor, 2024

ISSN 2226-7115



Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen,

nuk paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.

Materialet e sjella në redaksi,
pavarësisht nëse botohen apo jo,
nuk i kthehen autorit.

PËRMBAJTJA

4 Vetëllogaria, domosdoshmëri e kësokohe / Mehmet Disha

6 100 vjet Medreseja e Tiranës (1924 - 2024) / Dorian Demetja

10 Lajme / Aktivitete



14 Drejtësia dhe adhurimi / Dr. Ali Ünsal

18 Thyerja e zemres / Këshilli i çështjeve fetare - insi.al

20 Fuqia e përfaqësimit në kumtimin e fesë / Taulant Bica

22 Ateizmi dhe disa nga problemet e tij / Brahim Ramja

26 Pasqyrimi i botës shpirtërore në letërsinë dhe artin e realizmit socialist / Hasan Bello

28 Ura e xhenetit / Osman Xhill

30 Cilësitë e tiparet e atyre që ishin të denjë për pozicionin e kalifatit / M. Jusuf Kandeheleui



34 Destinimi i nji kombi / Redaksia

38 Mos më thoni... / poezi nga Hafiz Ali Korça



Vetëllogaria, domosdoshmëri e kësokohë

Ikja e shpejtë e kohës dhe vrulli i nxituar i kësaj epoke në të cilën jetojmë duhet të na rikthejë përherë e më shumë drejt parimeve të pastra që janë karakteristikë e besimtarit. Kjo për arsye se kriteret e Kur'anit dhe të Sunetit Profetik, janë strehë e shpëtimit nga të këqiat e këtij vrulli. Pavarësisht te gjitha furtunave dhe sprovave, a udhëve të gjynaheve që përpiqen ta tjetërsojnë robin, ta shtrembërojnë rrugëtimin e tij për tek Zoti, duhet ruajtur medoemos vija e drejtë, isatikameti, qëndrueshmëria dhe vazhdueshmëria në besim dhe teuekkul, mbështetje ndaj Zotit. Myslimani, në fundin e një dite, të një jave, a të muajit apo tekefundit, në përfundimin e një viti, duhet që të bëjë një vetëllogaritje për të parë se si po ecin gjërat në raport me fitimin e kënaqësisë së Allahut xh.sh.

Vërtet, janë një sërë zgjedhjesh e gabimesh që ne i bëjmë gjatë përditshmërisë e që pas njëfarë kohe ato na reflektohen mbrapsht duke na vënë në pah mangësitë. Këto gabime duhet që të kihen parasysh në mënyrë që të mos ripërsëriten, e që llogaria e tyre të mos mbetet për në botën tjetër.

Allahu thotë: **"Në ditën e gjykimit Ne do të vëmë peshore të drejta, e askujt nuk i bëhet as edhe një padrejtësi, edhe nëse është (vepra) sa pesha e një kokrrë të melit Ne do ta sjellim atë. E mjafton që Ne jemi llogaritës".¹**

Krahas kësaj, sipas përshkrimit profetik të një mëkati, gabimet që bëjmë dhe që i dërgojmë brenda në botën tonë shpirtërore, nuk qëndrojnë me aq, por japin një ndikim, një shkundje, një impakt të rëndë te zemra dhe në rast të mungesës së pendesës dhe kërkimfajes, duke mos u kthyer nga ai gabim, ai rritet, zgjerohet dhe merr efektin e një katarakti duke tërhequr si një vrimë e zezë rrugët gjer në mohim, Allahu na ruajtë! Kështu kjo shton riskun për humbjen e përjetësisë. Ndërsa, pëndesa, vënia e vetes në llogari, të treguarit kujdes në hapat e hedhura duke ruajtur vijën e kënaqësisë së Zotit, kjo shton shansin e fitimit të përjetësisë.

Allahu, gjithashtu në një ajet tjetër tërheq vërejtjen dhe thotë: **"...le të shikojë njeriu se çka ka bërë për nesër..."²**

Besimtarët janë gjithnjë plotësisht të vetëdijshëm që kanë ardhur në këtë botë për të mbartur një premtim (marrëveshje) shpirtërore që rezulton ose në fitim ose në humbje, që në terma të tjerë është ose Xheneti ose Xhehenemi. Është njeri i urtë ai i cili përpriqet në adhurim dhe i thotë shpirtit të tij: "O shpirti im, ti ke vetëm një jetë; asnjë moment të vetëm që të ka kaluar nuk mund të rikthehet, numri i frymëmarrjeve të tua që të jepen nga Allahu, janë të caktuara, dhe nuk mund të shtohen. Kur të mbarojë jeta, nuk mund të veprosh më asnjë vepër të mirë, prandaj atë që duhet ta bësh, bëje tani."

Në Ditën e Ringjalljes, njeriut do t'i shpalosen të gjitha veprat e bëra dhe do të gjykohet në bazë të tyre. Kështu seritë e tëra të orëve të jetës së njeriut do të shfaqen, një nga një, para shikimit të tij. Prandaj duhet t'i themi shpirtit çdo mëngjes, "Allahu ju ka dhënë njëzet e katër thesare, kini mendjen të mos ju humbasin ndonjëra prej tyre, që të mos jeni në gjendje të duroni keqardhjen që do t'iu vijë nga humbjet e tilla."

Përkujtimi i Allahut

Njeriu duhet t'i rikujtojë vetes sa herë që Allahu vëzhgon të gjitha veprat dhe mendimet e tij. Njerëzit shohin vetëm jashtë, ndërsa Allahu e sheh njeriun si në pamjen e jashtme ashtu edhe në atë të brendshmen.

Abdullah Ibn Dinari tregon: "Isha duke ecur njëherë me halifin Omer afër Mekës, kur u takuam me një djalë skllav-bari që ishte me kopenë e tij. Omeri i tha atij: "Më shit një dele." Djali u përgjigj: "Nuk janë të mijat, por të padronit tim." Pastaj, për ta vënë në provë, Omeri i tha: "Ma shit mua dhe padronit thuaji që e hëngri ujku." Bariu, i çuditur nga kjo kërkesë i tha: "Po Zotit të padronit, çfarë t'i them Ditën e Kijametit?!" Omeri u ul në gjunjë dhe filloi të qajë nga këto fjalë, pastaj e bleu atë rob dhe e liroi. Ai i tha bariut: "Për këtë thënie ju jeni i lirë në këtë botë dhe do të jeni i lirë në botën tjetër."

Ditën e Llogarisë do të pyetesh për secilën vepër që ke vepruar, pyetja e parë: "pse e ke bërë këtë vepër?", e dyta: "në çfarë mënyre e ke bërë këtë?", dhe e treta: "për çfarë qëllimi e ke bërë atë vepër?"

Pyetja e parë do të kërkohet për shkak se njeriu duhet të veprojë sipas udhëzimit hyjnor, e jo nga ndikimi njerëzor e djallëzor. Nëse kjo pyetje është përgjigjur kënaqshëm, pyetja e dytë do të provojë se në çfarë mënyre veprimi e ke bërë, me mençuri, apo me shkujdesje dhe neglizhencë, dhe pyetja e tretë, nëse është bërë thjesht për të kënaqur Allahun, apo për të fituar kënaqësinë e njerëzve. Nëse një njeri kupton kuptimin e këtyre pyetjeve, ai do të jetë shumë vigjilent mbi gjendjen e zemrës së tij.

Njeriu duhet të meditojë në mënyrë rigorozë se do të japë llogari për veprimet e tij që i ka bërë. Çdo mbrëmje ai duhet të shqyrtojë zemrën e tij për atë që ai ka bërë për të parë nëse ka fituar ose ka humbur në kapitalin e tij shpirtëror. Kjo është më se e nevojshme, ngase nefsi është gjithnjë i gatshëm të miklojë e të mashtrtojë, ndonjëherë ai paraqet egoizmin e vet nën maskën e bindjes ndaj Allahut, në mënyrë që ti mendon se ke fituar, kur në realitet ke humbur.

Një njeri i drejtë me emrin Amija, gjashtëdhjetë vjeç, llogariste ditët e jetës së tij. Ai numëroi 21.600 ditë. Ai tha me vete, "Sa keq! Nëse unë kam kryer një mëkat çdo ditë, si mund të shpëtoj në nga ngarkesa e 21.600 mëkateve?" Ai nxori një britmë dhe ra për tokë, kur erdhën për ta ngritur atë, e gjetën të vdekur.

Mirëpo shumica e njerëzve janë të pavëmendshëm, dhe kurrë nuk mendojnë për llogarinë e vetes. Njerëzit llogarisin në tespihët (rruzat) e tyre me vetë-kënaqësi numrin se sa herë kanë përmendur emrin e Allahut, dhe harrojnë të llogarisin fjalët e panumërta të kota që flasin.

Së fundmi, nëse ndonjëri e gjen veten neglizhent dhe jo të prirur që të jetë serioz në procesin e vetë-disiplinës dhe vetëllogarisë, duhet të shoqërohet me atë që është i aftë në praktika të tilla në mënyrë që të rrisë entuziazmin e tij. Një njeri i drejtë kishte thënë: "Kur më rritet pasiviteti në vetë-disiplinë, unë shoh Muhamed Ibn Uasin, dhe sytë e tij rindezin te unë entuziazmin tim për të paktën një javë."

1 Kuran, 21:47.

2 Kuran 59:18.

100 vjet Medreseja e Tiranës (1924-2024)



Në Shqipëri, disa shekuj më parë, institucionet mësimdhënëse fetare kanë qenë pranë xhamive dhe në të mësohej kryesisht Kur'ani Famëllartë dhe njohuritë bazë të fesë Islame. Kurse për medresetë, si institucione serioze të arsimit kombëtar fetar islam, mund të flasim vetëm pas Shpalljes së Pavarësisë.

Ideja e hapjes së medresesë shtronte nevojën e rishikimit të metodave, hartimit të programeve mësimore dhe përcaktimit të objektivave për edukimin e nxënësve me ndjenja fetare e kombëtare. Medreseja nuk u hap brenda një dite; u desh shumë mund, shumë bisedime,

duheshin zgjidhur shumë çështje e nën-çështje financiare, duhej siguruar personeli pedagogjik, ambienti i mësimi, literatura mësimore didaktike, etj. Ideatorët, flamurtarët e pastaj nismëtarët e kësaj lëvizjeje për ta çuar përpara problemin, u bënë ata që kishin marrë mësim në shkolla të përparuara të botës islame ose që kishin dhënë leksione ndër kësi shkollash si mësues e pedagogë. Autorë të veçantë prezantonin përvojën personale se si mund të themelohej një medrese në shërbim të Islamit, në shërbim të Atdheut.¹

1. Faik Kasollja, Hoxhallarët, kategori e respektuar e shoqërisë

Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfeve në shkresën e datës 2 qershor 1923, i raporton Këshillit të Naltë të Sheriatit mbi ndërtimin e Medresesë:

"1) Sot për sot, pasi pasuria e Xhema'atit Mysliman nuk mund të përballojë shpenzimet që duhen për ndërtimin e Medresesë së Përgjithshme dhe për institutin në fjalë ekziston një nevojë e madhe dhe e ngutshme, mendojmë përsëri se, sa të përmirësohet gjendja financiare e xhema'atit, të merret këtu në kryeqytet me qira një godine e favorshme e të formohet në të medreseja.

2) Në këtë medrese të merren prej çdo prefekturë nga 5 nxënës, duke u siguruar shpenzimet e tyre prej vakfit të prefekturave.

3) Mësimet të ndahen në 3 kategori - fillore, lice e universitet dhe periudha mësimore e secilës kategori të jetë 4 vjet.

4) Nxënësit që kanë mbaruar filloren në medrese të vendit, të pranohen në rendin e prapmë të kategorisë fillore.

5) Përveç atyre që do të vazhdojnë studimet me kursimet e vakëfeve të qarkut, të pranohen edhe nxënës të pasur që dëshirojnë të ndjekin mësimet në Medrese, me kusht që të paguajnë shumën e shpenzimeve që u përkasin. Presim vendimin e Këshillit të Naltë të Sheriatit që të nisim marrëveshjet me zyrat e qarkut."²

Në vendimin e Këshillit të Naltë të Sheriatit nr. 52, të datës 4 qershor 1923 citohet: "Këshilli i Naltë i Sheriatit lexoi shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfeve të datës 2 qershor 1923, nëpërmjet së cilës propozohet që të merret një vendim nga ana e Këshillit të Naltë të Sheriatit për pranimin e formimit të një Medreseje të Përgjithshme në Tiranë, sipas konditave të treguara në shkresën e sipërpërmendur, që kështu Drejtoria në fjalë të fillojë pa humbur kohë përgatitjet e duhura. Mbase u pa i arsyeshëm e i pëlqyeshëm propozimi i lartpërmendur, u vendos pranimi i formimit të Medresesë së sipërtreguar prej tri klasash, e cila do të funksionojë sipas një programi e rregulloreje të posaçme dhe me këtë mënyrë autorizohet Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfeve për të bërë marrëveshjet e duhura me të gjitha prefekturat për sigurimin e nxënësve si edhe për shpenzimet e duhura, duke njoftuar Këshillin në përfundim."³

Medreseja e Naltë në Tiranë u hap më 01.03.1924 me vendim të Kongresit të Parë të Myslimanëve Shqiptarë dhe me lejen e Ministrisë së Arsimit N. 105/1, datë 25.02.1924,⁴ për të plotësuar nevojat për kuadro fetarë. Kjo shkollë islame u hap me një personel tërësisht shqiptarë, me programe e organizim bashkëkohor, të hartuara e administruara nga teologë shqiptarë dhe,

shqiptarë, revista "Zani i Naltë", nr. 8 (161), korrik-gusht-shtator 2014, f. 21-22.

2. AQSH, fondi 482, viti 1923, dosja 76, fleta 37.

3. AQSH, fondi 482, viti 1923, dosja 3, fleta 74.

4. *Ceremonia e shpërdamjes së diplomave maturanëve të medreses, revista "Zani i Naltë", nr. 3-4, nëntor-dhjetor 1932, f. 460.*

shpenzimet për ecurinë e saj u përballuan nga të ardhurat e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

Fillimisht, Medreseja filloi nga puna në ambientet e ndërtuara në shtëpinë e Haqim Maçit, lagjja Sulejman Pasha⁵ (pranë xhamisë së Sulejman Pashës dhe godinës së vjetër të Komunitetit Mysliman). Ndërtesa e specifikuar për Medresenë e Tiranës u përrua më 20.12.1931 në prani të të gjithë elitës së kohës.⁶

Në kuadrin e riorganizimit të rrjetit arsimor fetar në Shqipëri, në Kongresin e Tretë të Myslimanëve Shqiptarë më 1929, u vendos të suprimohen të gjitha medresetë e qyteteve të lartpërmendura dhe të mbetet vetëm ajo e Tiranës, e cila do të quhej "Medreseja e Përgjithshme". Nga bankat e Medresesë së Naltë kanë dalë figura të shquara të shkencës shqiptare si historiani Vexhi Buharaja, akademiku Shaban Demiraj etj. Disa nga maturanët e parë të kësaj Medreseje që u diplomuan në vitin 1932, pasi kryen studimet e larta, punuan po këtu me përkushtim si mësues apo drejtues të saj.

Rihapja e Medresesë së Tiranës pas çlirimit të vendit

Rihapja e Medresesë së Tiranës pas çlirimit të vendit, u pa me shumë prioritet nga stafi drejtues i KMSH-së, e për këtë, u mor vendim që Medreseja të rifillojë mësimin e rregullt pas disa riparimeve të bëra, për shkak të dëmtimeve nga luftimet. Me të njëjtin vendim u vendos Hafiz Ismet Dibra drejtor i këtij institucioni.⁷ Këshilli i Përhershëm i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë me vendim nr. 9, datë 23.05.1945 vendosi që Medreseja e Përgjithshme të çelë dyert e saj më 01 qershor 1945.⁸

Ishte merita e Medresesë së Përgjithshme, e trupit mësimdhënës, veçanërisht e drejtorit të saj, Hafiz Ismet Dibrës, si dhe e kolegëve të tij: Jonuz Buliqit, sheh Qazim Hoxhës, Haki Sharofit, H. Ibrahim Dalliu, H. Ali Korçës, etj., të cilët, me punën e tyre intensive e të palodhur, me shkrimet e veprat e botuara dhe me patriotizmin që i karakterizonte, përgatitën breza studentësh, të cilët u bënë përçues të denjë të Islamit, duke ia rritur njëkohësisht nderin edhe kombit.

Nga regjimi komunist, ashtu si feja e besimi në përgjithësi, edhe Medreseja e Tiranës pati goditje me ashpërsi në rritje, duke nisur me reformën arsimore të vitit 1946, e cila ia kufizoi ndjeshëm lëndët fetare, ndërsa lëndët e kulturës së përgjithshme ia detyroi si të një shkollë profesionale. Pushteti komunist i imponoi me vendim të veçantë një plan-program mësimor, që prekte thellë fizionominë dhe përmbajtjen e saj. Ministria e Arsimit gradualisht u përpoq që programi i shkollës të shkojë drejt laicizmit. "Mbledhja e Ministrisë së Arsimit më 16 tetor 1946, vendosi që shkolla fillore pranë Medresesë

5. *Medreseja e Përgjithshme (Universite) e Komunitetit Mysliman, revista "Zani i Naltë", nr. 5, shkurt 1924, f. 146.*

6. *Inaugurimi i ndërtesës së Medresesë, revista "Zani i Naltë", nr. 5, janar 1931, f. 111.*

7. Shyqyri Hysi (Dr.), *Muslimanizmi në Shqipëri në periudhën 1945-1950*, Tiranë 2006, f. 147.

8. AQSH, fondi 482, viti 1945, dosja 3, fleta 9.

të mbyllej, kurse numri i klasave të mesme të reduktohej në 4.⁹

Regjimi komunist, shumë drejtues e mësues të Medresesë së Tiranës i përndoqi, i burgosi dhe i dënoi me egërsi. Më 11 dhjetor 1946 arrestohet drejtori i Medresesë Hafiz Ismet Dibra me një arsyetim si kundërshtar politik i regjimit komunist. Edhe nxënësit e Medresesë patën presione të ndryshme, duke i thirrur ata qëllimisht për ushtar apo duke i orientuar që arsimin ta vazhdojnë në shkolla të tjera shtetërore.

Sipas vendimit nr. 1 dt. 22.08.1964 të Këshillit të Përgjithshëm, Medreseja e Tiranës hëpërhë mbyllet për arsye të forta buxhetore dhe se tani për tani ka kuadro të bollshëm.¹⁰ Një goditje e fortë iu dha Komunitetit Mysliman, kur më 27 dhjetor 1965 konfiskohet nga shteti pa asnjë shpjegim godina e Medresesë së Tiranës, duke iu kaluar në dispozicion Fakultetit të Mjekësisë, dega Stomatologji, gjendje e cila vazhdoi edhe pasi vendi kaloi në një regjim demokratik.¹¹ Kjo frymë ateiste vazhdoi deri në vitin 1990.

Ringritja e Medresesë së Tiranës me fillimin e proceseve demokratike

Në shkresën e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë të datës 10.10.1991, me numër 1 të protokollit, drejtuar Myftinisë Tiranë, H. Sabri Koçi citon: "Me vendimin e marrum nga ky Komunitet, është vendosur që në qytetin e Tiranës do të ngrihet shkolla e mesme MEDREZE e emërtueme 'Haxhi Mahmud Dashi'. Personeli që do të japi mësim në kulturën e përgjithshme, do i sigurohet paga nga ana e këtij Komuniteti simbas orëve dhe normave në fuqi për arsimin e përgjithshëm."

Në vitet e para, medresetë u përballën me vështirësi të mëdha e serioze që i kapërcyen gradualisht, duke filluar nga mungesa e ndërtesave, e mjeteve didaktike-mësimore, kuadri i kualifikuar mësimdhënës, programet e deri te tekstet mësimore aq të nevojshme. Kërkesa për bazë materiale për shkollat fetare, si banka, katedra, tabela të zeza, etj., dërguar Bashkësisë së qytetit të Tiranës nga H. Sabri Koçi, tregon fare qartë mungesën dhe nevojën e madhe në këtë drejtim.¹²

Për ringritjen e Medresesë së Tiranës "Haxhi Mahmud Dashi", ish-mësuesi i saj z. Ali Hoxha thotë: "Në datën 16.10.1991 Medreseja e Tiranës hap dyert për nxënësit e vitit të parë të arsimit të mesëm. Nismëtarët e rihapjes së Medresesë së Tiranës ishin njëkohësisht edhe mësuesit e saj, Ibrahim Balla, Mehmet Sinella, Xhavit Alimehmeti, Ali Hoxha, Selim Stafa, Xhemal Balla dhe Ismet Tancica.

9. Shyqyri Hysi (Dr.), *Muslimanizmi në Shqipëri në periudhën 1945-1950*, f. 156.

10. AQSH, fondi 482, viti 1964, dosja 6, fleta 1.

11. Myzafer Kazazi (Prof. Dr.), *Tirana kryeqytet, ndryshimet urbane dhe objektet e kultit musliman*, revista "Drita Islame", nr. 15, shtator 1999.

12. Kërkesë për bazë materiale për shkollat fetare – Bashkësisë së qytetit të Tiranës, datë 31.03.1993, arkivi i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

Si përgjegjës për punët e shkollës, zgjidhet fillimisht z. Ibrahim Balla, i cili emërohet drejtor i medresesë një vit më pas nga Komuniteti Mysliman." Medreseja e Tiranës "Haxhi Mahmud Dashi" u hap fillimisht pranë xhamisë së Kokonozit me një klasë, ku paradite bënin mësim nxënësit nga rrethinat e Tiranës dhe pasdite nxënësit me banim brenda qytetit. Në shtator të vitit 1995, nxënësit fillojnë të bëjnë mësim në godinën e vet historike të Medresesë së Tiranës.

Në planet mësimore të medresesë u përfshinë lëndët e kulturës së përgjithshme të shkollave të mesme të përgjithshme dhe lëndët fetare: Kur'an, Besim, Fikh (Jurisprudenca Islame), Tefsir (Komentimi i Kur'anit) Hadith (Tradita profetike), Histori islame, si dhe gjuhët e huaja arabisht e anglisht. Për sa i përket strukturës administrative të medreseve, ato administrohen sipas protokolleve të parashikuara prej Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe fondacioneve përkatëse që i sponsorizojnë.

Sot, falë kujdesit të vazhdueshëm të KMSH-së dhe kontributeve financiare të shoqatave bamirëse e fondacioneve, tashmë Medresetë (të shtrira në qytetet Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Elbasan) kanë siguruar godina të reja e të bukura, mjedise të përshtatshme bashkëkohore për mësim dhe fjetje, laboratorë, biblioteka, palestra, kënde sportive, materiale didaktike e mjete informacioni të fjalës së fundit. Objektivi kryesor i medreseve ka qenë dhe mbetet brumosja e nxënësve me njohuritë e moralin islam, me ndjenja kombëtare e me vizion të qartë për të ardhmen, pajisja me dije të thella e të qëndrueshme që do t'u shërbejnë atyre për të përballuar sfidat e jetës në shoqërinë e sotme demokratike.¹³

Stafi mësimor i Medresesë së Tiranës punon shumë që nxënësit t'i shfrytëzojnë aftësitë e tyre jo vetëm për vete, por edhe për familjen, shoqërinë e mbarë kombin. Për këtë qëllim zhvillohen edhe veprimtari praktike orientuese, që nxënësit e Medresesë së Tiranës të dinë të tërheqin në rrugën e drejtë të Islamit edhe persona të tjerë të afërm ose të njohur. Me gjithë vështirësitë e kohës, Medreseja e Tiranës e ruan profilin e saj, duke ofruar për nxënësit arsimin dhe edukimin e duhur të ndërthurur me frymën fetare e kombëtare, mision të cilin vazhdon ta kryejë me përkushtim edhe sot.

Më 17.03.2015, me numër dekreti 8997, ish Presidenti i Republikës së Shqipërisë, SHT.Z. Bujar Nishani, i ka akorduar Medresesë së Tiranës titullin "Për merita të veçanta civile" me motivacionin: "*Si një shkollë e arsimit fetar në Shqipëri, e cila, duke u bërë pjesë e arsimit tonë, përgatiti për disa dhjetëvjeçarë në një nivel të lartë një plejadë teologësh myslimanë, të cilët luajtën një rol parësor në ripërtëritjen e moralit tonë kombëtar.*"

Dorian Demetja

13. Hiqmet Patozi, Medreseja e Naltë e Tiranës, ëndrra e besimtarëve islamë, revista "Zani i Naltë", nr. 10 (163), janar-shkurt-mars 2015, f. 105.





1

PANAIR BAMIRËSIE NË MBËSHTETJE TË GRAVE TË DIAGNOSTIKUARA ME KANCER

Zyra e Gruas pranë Komunitetit Mysliman të Shqipërisë (KMSH) organizoi një panair ushqimor bamirësie me rastin e festave kombëtare të Pavarësisë dhe Çlirimit të vendit, më 28-29 nëntor. Aktiviteti, i mbajtur në sheshin "Fan Noli", përballë godinës së KMSH, zgjati dy ditë dhe tërhoqi një interes të madh nga qytetarë shqiptarë dhe të huaj.

Të ardhurat e mbledhura nga Panairi i Bamirësisë do të shkojnë për mbështetjen e grave të diagnostikuara me kancer, duke ofruar një dritë shprese dhe ndihmë konkrete për përballimin e sfidave shëndetësore.

Panairi u organizua nën kujdesin e Përgjegjëses së Zyres së Gruas, znj. Fatma Karaj, dhe specialistes pranë kësaj zyre, znj. Nadia Lika, të cilat koordinuan aktivitetin me ndihmën e vajzave vullnetare. Pjesëmarrja e tyre aktive ishte një shembull i përkushtimit dhe humanizmit.

Qytetarët që vizituan panairin shprehën mirënjohjen për mundësinë që iu dha për të bërë bamirësi, duke kontribuar në përmirësimin e jetës së grave në situatë të vështirë shëndetësore.

Zyra e Gruas falenderoi të gjithë kontribuesit, qytetarët që morën pjesë, si dhe restorantet dhe pastičeritë që sollën ushqime në ndihmë të kësaj fushate humanitare.

Ky aktivitet ishte një shembull frymëzues i solidaritetit dhe bashkimit për një qëllim fisnik, duke forcuar vlerat e bamirësisë dhe dashurisë për njerëzit në nevojë.





2

PËRFAQËSUES NGA MINISTERIA E VAKFEVE DHE ÇËSHTJEVE FETARE TË KATARIT VIZITOJNË KMSH-NË

H. Bujar Spahiu, kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, priti në selinë e KMSH-së një delegacion përfaqësues nga Ministria e Vakfeve dhe Çështjeve Fetare të Katarit, me në krye z. Muhamed Xhabar el-Menai, Drejtor i Drejtorisë së Çështjeve Fetare pranë kësaj ministrie, i shoqëruar nga Shkëlqesia e Tij Jabor bin Ali al Dosari, Ambasadori i Katarit në vendin tonë.

Gjatë takimit, kryetari Spahiu, i njohu me organikën e institucionit dhe veprimtarinë e tij fetare dhe sociale.

Nga ana e tij, z. Muhamed Xhabar el-Menai, prezantoi përgjegjësitë dhe detyrat kryesore të drejtorisë që ai përfaqëson pranë Ministrisë së Vakfeve dhe Çështjeve Fetare në Katar.

Më pas, Kryetari me ekipin e tij dhe delegacioni në fjalë, zhvilluan një takim më të detajuar ku diskutuan mbi projekte dhe fusha të ndryshme bashkëpunimi.

Kjo vizitë shërbeu si një mundësi e vyer për të diskutuar qëllimet e përbashkëta, për të forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional dhe për të eksploruar iniciativa që do t'i shërbejnë më mirë komuniteteve tona.

KMSH pret që kjo vizitë të kthehet në një partneritet të frytshëm në të ardhmen.





3

**KRYETARI SPAHIU ZHVILLON TAKIME PUNE ME MYFTININË
ELBASAN DHE ATË TË GJIROKASTRËS**

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, së bashku me anëtarë të tjerë të kryesisë së institucionit, zhvilluan një vizitë punë në Myftininë e Elbasanit, ku u pritën nga Myftiu Agim Duka, administratori dhe imamët e myftinisë.

Kjo vizitë vjen në kuadër të ndjekjes së objektivave vjetore të vendosura më herët në mbledhjet e zhvilluara për planin strategjik të punës 2024-2029.

Në fjalën e rastit, myftiu Duka, bëri një rezymë të shkurtër të ecurisë së deritanishme të objektivave më madhore të myftinisë.

Ndërsa kryetari Spahiu, vlerësoi përpjekjet e Myftiut dhe imamëve në zhvillimin e vazhdueshëm si në aspektin institucional po ashtu edhe në atë fetar e social.

Takimi vijoi më tej duke prekur një sërë temash aktuale.

I njëjti takim pune u zhvillua edhe me Myftininë e Gjirokastrës, ku kryetari Spahiu dhe përfaqësues të tjerë të institucionit, u pritën nga Myftiu Senja dhe imamët përkatës.





4

MOHUMMED UMAR SAYED, KREU I ORGANIZATËS “MIRËSI PËR BOTËN” VIZITON KMSH-NË

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim në selinë e institucionit, z. Mohummed Umar Sayed, kreun e organizatës “Mirësi për Botën”.

Ky takim vjen në kuadër të marrëdhënieve dhe bashkëpunimeve të njëpasnjëshme ndërmjet dy palëve, me synimin e mbështetjes së aktivitetit fetar në xhami të ndryshme të vendit, ndihmesën e shtresave në nevojë, hapjen dhe menaxhimin e jetimoreve, zhvillimin e aktiviteteve të bamirësisë, etj.

Bashkëbisedimi ndërmjet dy krerëve u fokusua në mbarëvajtjen e implementimit të marrëveshjeve të lartpërmendura, si dhe vizionin e përbashkët në konsolidimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të këtyre projekteve.


Në fjalën e tij, kryetari Spahiu, e falënderoi z. Sayed për mbështetjen e ofruar për imamë të shumtë në Shqipëri deri më tani dhe vlerësoi përpjekjet e organizatës “Mirësi për Botën” në misionin fisnik për t’iu ardhur në ndihmë kategorive të ndryshme me vulnerabël të shoqërisë sipas nevojave përkatëse si në vendin tonë, ashtu edhe në pjesë të ndryshme të botës.

Ndërsa z. Sayed, e falënderoi kryetarin Spahiu për bashkëpunimin dhe theksoi se organizata e tij synon të kontribuojë sa më shumë në përpjekjet e KMSH-së për përmirësimin e kushteve të punës për myftinjtë dhe imamët e institucionit.

Takimi vijoi më tej në formën e një bashkëbisedimi të lirë.



DREJTËSIA DHE ADHURIMI



Bediuzzamani, kur flet për temat themelore të trajtuara në Kur'anin Kerim, thotë: 'Elementet thelbësore të Kur'anit dhe qëllimet që ai ndjek janë katër: teuhid (monoteizmi), nubuvet (pejgamberia), hashr (ringjallja), adalet (drejtësia) dhe ibadet (adhurimi).¹ Ai i përmend së bashku konceptet 'adalet' dhe 'ibadet'. Ka nuanca të rëndësishme në shqyrtimin e këtyre dy koncepteve së bashku.

Platoni, Ibn Miskavej, Imam Gazzali dhe Bediuzzaman kanë një vlerësim të ngjashëm për njohjen dhe kuptimin e njeriut. Njeriu është i përfshirë në ndryshime dhe fatkeqësi. Ai është një qenie që lëviz në rrjetin e pikave ekstreme. Megjithatë, që shpirti i tij të jetë në trup, i janë dhënë tri lloj fuqish (kuvve) të rëndësishme. Këto janë: 'kuvve shehevije/fuqia e dëshirës' për të tërhequr gjëra të dobishme, 'kuvve gadabije/fuqia e zemërimit' për të shmangur gjërat e dëmshme dhe 'kuvve aklive/fuqia e arsyes' për të dalluar të dobishmen nga e dëmshme, mirësinë nga e keqja. Këto fuqi kanë pika ekstreme në drejtimin e ifratit (të qenit më shumë se ç'duhet) dhe tefritit (të qenit më pak se ç'duhet).

Pika ekstreme e tepërimit të kuvve-i shehevije është fuxhur, që do të thotë të mos njohësh kufij të nderit dhe moralit për dëshirat që ke. Ndërsa pika ekstreme e mangësisë është humu, që nënkupton të mos ndjesh shije as edhe për gjërat e lejuara. Kjo do pengonte vazhdimin e brezave. Pika e mesme e këtyre është iffet/dëlirësia, e cila është dëshira për atë që është hallall dhe të mos i hapësh derë asaj që është haram.

Niveli ekstrem i kuvve-i gadabije është tahavuri, që do të thotë të mos kesh frikë nga asgjë dhe të mos njohësh kufij. Shtypja, dominimi dhe diktaturat janë rezultat i kësaj ndjenje. Mangësitë e kësaj force janë frika dhe pasiviteti. Ekuilibri i tij është shexha', pra guximi që vjen nga besimi. Kjo do të thotë të bësh të gjitha llojet e sakrificave për hir të urdhrave të fesë dhe vendosjes së drejtësisë, por jo të merresh me veprimtari të paligjshme.

Ekstremi i kuvve-i aklive është se një person, me inteligjencën e tij mashtruese, e bën të vërtetën të duket e rreme dhe gënjeshtër të duket e vërtetë. Mangësia është gabavet, pra marrëzi, që është mungesa e drejtimit deri në atë masë sa të mos dallosh të drejtën nga e gabuara. Një njeri i mençur e njeh të vërtetën si të vërtetë dhe mbahet fort pas saj; Ai e njeh gënjeshtër si gënjeshtër dhe i shmanget asaj. Adaleti del nga kombinimi i këtyre tre forcave, të cilat janë shumë të rëndësishme për jetën e njeriut.²

Drejtësia

Në arabisht, fjala "adalet" rrjedh nga rrënja "a-d-l,"³ që do të thotë të jesh i drejtë, të sillesh drejt, të gjykos me drejtësi, dhe të barazosh. Ajo përmendet në Kur'an në 28 vende, së bashku me derivatet e saj. Në Kur'anin e Shenjtë

dhe në hadithet zakonisht përdoret me kuptime si "rregull, ekuilibër, barazi, drejtësi në gjykim, ndjekja e rrugës së drejtë, devotshmëri, ndershmëri, paanësi."

Imam Gazzali thotë se nëse atributi i drejtësisë humbet, nuk do të ketë dy anë në formë të tepërimit apo mangësisë (ifrat-tefrit), aty do të lindë vetëm kundërshtimi dhe kontradikta, që është xhevr/zullumi.⁴ Ai thotë se drejtësia duhet të realizohet në tri vende: në vetveten e personit, në veprimet e tij dhe në punët e tij administrative.⁵

Nushirevan, i njohur në histori për udhëheqjen e tij të drejtë, e përshkruan kështu drejtësinë në botë: "Sovrani vjen me shtetin, dhe shteti me ushtrinë; ushtria me para, ekonomi, dhe pasurai me tatim; tatimi me ndërtimin e vendit, dhe ndërtimi i vendit me përmirësimin e tij, drejtësia vazhdon me përmirësimin e udhëheqësve (dhe zyrtarëve). Nëse drejtësia nuk përmirësohet, udhëheqësit nuk do të kenë moral të drejtë dhe të ndershëm. Kreu dhe baza e të gjitha këtyre është që sundimtari të hetojë vetë gjendjen e popullit dhe të jetë në gjendje të edukojë popullin. Nëse sundimtari është kështu, populli e ruan atë dhe është i sigurt për të, pasuria dhe pronat e tij nuk do të shkatërrohen."⁶

Bediuzzamani në koleksionin Risale-i-Nur ka sjellë kuptime të ndryshme për konceptin e drejtësisë. Në bazë të manifestimit të saj, janë përdorur terma si drejtësia e pastër, drejtësia e krahasuar, drejtësia e vërtetë, drejtësia e plotë, drejtësia e pafundme, drejtësia hyjnore, drejtësia kur'anore, drejtësia e fatit dhe drejtësia njerëzore. Për më tepër, ai e ka ndarë drejtësinë në dy pjesë, drejtësi pozitive dhe drejtësi negative, duke e kuptuar 'drejtësinë pozitive' si dhënien e të drejtës atij që i takon, dhe 'drejtësinë negative' si disiplinimin e padrejtësive.⁷

Adhurimi

Adhurimi është emri i robërisë ndaj Allahut në nivelin më të lartë, në kuptimin më të thellë dhe në kontekstin më të gjerë, me dashuri të sinqertë dhe respekt të thellë. Kjo është një robëri aq e pastër sa burimi i tij është vetëm dashuria ndaj Allahut dhe ndjenja e mirënjohjes për të mirat e Tij të pafundme. Prandaj, adhurimi është titull i marrëdhënies së njeriut me Zotin e tij. Falë adhurimit njeriu kupton shumë mirë se kush është Krijuesi, kush është krijesa, kush është Pronari, kush është prona, kush është i Fuqishmi dhe kush është i pafuqishmi, kush është i Pasuri e kush është i varfëri dhe ai e di shumë mirë pozitën e tij para Zotit të tij. Kjo e çon atë në disiplinë të brendshme. Në këtë mënyrë ai disiplinon nefsën e tij dhe rregullon sjelljen dhe gjendjen e tij. Ai është i bindur ndaj çdo urdhri të Zotit të tij dhe i

4. Imam Gazzâlî, Ihyâu Ulûmi'd-Dîn, prkth. Ahmed Serdaroğlu, İstanbul: Bedir Yayınları, 2003, v. 3, fq. 127.

5. Imam Gazzâlî, Kimyâ-yı Saadet, prkth. A. Faruk Meyan, İstanbul: Bedir Yayınları, 1996, fq. 21.

6. Fatma Ünal (ed.). Hukuk ve Adalet Öğretimi Materyali, Ankara: Millî Eğitim Bakanlığı Yayınları, 2018, fq. 14.

7. Shih Bediuzzaman Said Nursî, Sözlür, İstanbul: Şahdamar Yayınları, 2010, fq. 90.

1. Bediuzzaman Said Nursî, İsharatü'l-İcaz, İstanbul: Sözlür Neşriyat, 2007, fq. 9.

2. Po aty, fq. 20-22.

3. Mukerrem Muhammed Mandhur, Lisanu'l-Arab, Bejrut: Dar Sader, 2003, v. 10, fq. 6165.

durueshëm ndaj çdo ndalese. Si një shfaqje natyrore e kësaj, ndjeshmëria ndaj së drejtës dhe drejtësisë rritet.

Raporti i drejtësisë me adhurimin

Njeriu që përmes adhurimit rrit disiplinën e tij personale ndihmon gjithashtu në arritjen e disiplinës sociale dhe drejtësisë. Për shembull, falja e namazit me xhemat sjell vëllazërinë, agjërimi ndihmon në ndarjen e ndjenjave me të varfërit dhe dhënia e zekatit ndihmon në heqjen e hendekëve ndërmjet klasave. Bota e brendshme e njeriut formon marrëdhëniet e tij me botën e jashtme. Nëse brenda tij ka çrregullim dhe shqetësim, ai mund të jetë shkatërrues dhe i dëmshëm edhe jashtë. Adhurimi, për shkak se rregullon paqen dhe ekuilibrin e brendshëm të njeriut, gjithashtu jep një ndihmë të madhe në krijimin e rendit në botën e jashtme. Për shembull, adhurimi e bën njeriun më besnik ndaj premtimeve që i ka dhënë Allahut. Njeriu kujton se nuk do të shkelë të drejtat e të tjerëve, se nga dora dhe gjuha e tij nuk do të dëmtojë askënd, se nuk do të fle i ngopur kur fqinji i tij është i uritur, se nuk do të'i mashtrojë njerëzit, se nuk do të vjedhë, se nuk do të vrasë askënd pa të drejtë, se nuk do të'i vë sy nderit dhe moralit të askujt, se nuk do të dëmtojë pasurinë e individëve ose të publikut dhe se gjithmonë do të qëndrojë besnik ndaj premtimeve të tjera që ka dhënë.

Në suren el-Fatiha, pas shprehjes "Ne vetëm Ty të adhurojmë", vazhdon lutja që thotë: "Na udhëzo në rrugën e drejtë. Në rrugën e atyre që i ke bekuar..." Se kush janë këta që janë bekuar, shpjegohet në një ajet tjetër. Këta janë peygamberet, të sinqertët, dëshmorët dhe vepër-drejtët. Ka një lidhje midis këtyre dy ajeteve.⁸ Pra, ne, me udhërrëfyesit tanë të cilët janë peygamberet, të sinqertët, dëshmorët dhe vepër-drejtët (të cilët janë imamët tanë), adhurimin tënd e bëjmë së bashku dhe dëshirojmë që të na udhëzosh në rrugën e drejtë që Ti e pranon. Për këtë, së pari, të falënderojmë, sepse falënderimi të takon vetëm Ty.

Thuhet se ne adhurojmë dhe kërkojmë udhëzim nga Ti. Udhëzimi nënkupton që njeriu, nga një këndvështrim, të respektojë të gjitha detyrimet e tij, të veprojë në mënyrë të ekuilibruar në çështje të ushqimit, të pijes, të veshjes dhe në çdo aspekt fetar dhe jetësor, të kryejë detyrat e tij dhe të qëndrojë larg mëkateve, dhe të jetë në rrugën e adhurimit sipas udhëzimit të fesë dhe arsyes, që do të thotë gjithashtu të jetosh në drejtësi.⁹

Bediuzzamani vë në dukje se drejtësia është e dy llojeve: e para është t'i japësh të drejtën atij që i takon, e dyta është të disiplinosh ata që bëjnë padrejtësi. Ai thotë se pas besimit, çështja më e rëndësishme është vepra e mirë, e cila në të vërtetë konsiston në mosshkeljen e të drejtave materiale dhe shpirtërore të njerëzve dhe në kryerjen/zbatimin me përpikëri të së drejtës hyjnore.¹⁰

8. Shih surja Nisa, 4/69.

9. Shih Sejjid Sherif Xhurxhani, koncepti "Istikamet", Muxhemu't-Ta'rifat, Kajro: pa vit botimi, Daru'l-Fadile, fq. 90.

10. Bediuzzaman Said Nursi, Lem'alar, İstanbul: Şahdamar

"Ai që braktis adhurimin, bën padrejtësi ndaj nefsit të vet (nefsi është rob dhe i nënshtruar ndaj Zotit) dhe gjithashtu bën një shkelje dhe padrejtësi ndaj të drejtave të përsosmërisë së universit. Po, ashtu si mosbesimi është një përçmim ndaj krijesave, edhe braktisja e adhurimit është një mohim i përsosmërisë së universit. Për më tepër, duke qenë se është një shkelje e urtësisë hyjnore, kushdo që e braktis adhurimin i nënshtrohet rrezikut të tmerrshëm dhe ndëshkimit të rëndë."¹¹ Kjo tregon se ai që neglizhon adhurimin, jo vetëm që shkel të drejtën e Zotit, por edhe të drejtat e njeriut dhe të universit. Në këtë mënyrë, adhurimi bëhet themeli i drejtësisë, dhe ai që e braktis atë, bën padrejtësi ndaj të dyjave. Në këtë mënyrë, adhurimi ndihmon në arritjen e përsosmërisë së drejtësisë dhe luan një rol plotësues.

Nga ana tjetër, një besimtar që e sheh drejtësinë si një ekuilibër dhe rend në të gjithë universin dhe tek vetja e tij, vëren se çdo gjë është vlerësuar me një masë të mrekullueshme dhe mbushet me ndjenjën e falënderimit ndaj Krijuesit të Madhërisë. Drejtësia që sheh në marrëdhëniet e tij shërben si një mjet për forcimin e dashurisë, unitetit dhe bashkimit. Dashuria, respekti dhe vëllazëria që lindin mes tyre i bën ata si gjymtyrët e një trupi të vetëm. Kështu, drejtësia që sheh e bën atë të kuptojë vlerën e parimeve që beson dhe e mbush me ndjenja falënderimi ndaj Krijuesit.

Në përfundim, adhurimi ndihmon në arritjen e përsosmërisë së drejtësisë, ndërsa drejtësia ka një fuqi nxitëse në adhurim. Kur përmendet 'drejtësia', menjëherë të vjen në mendje 'drejtësia sociale'. Fethullah Gülen Hoxhaefendi, i cili beson se besimi dhe adhurimi kanë një rol të madh në vendosjen e drejtësisë sociale, thotë se në periudhën e lumturisë (Asr-i Saadet), falë besimit të fortë që kishin njerëzit dhe mënyrës së përlulët të jetesës, fillimisht individët u reformuan, e më pas në atë shoqëri asnjë individ nuk i shkaktonte dëm material shoqërisë dhe nuk e shihte veten të ndarë prej saj, dhe drejtësia sociale arrinte vetvetiu në shoqërinë e krijuar nga njerëz me këtë botëkuptim.¹² Një tjetër dijetar i madh islam, Muhammed Ebu Zehra, gjithashtu vë në dukje rëndësinë e detyrës së 'urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja' për përhapijen e drejtësisë në shoqëri. Pra, kur ligjet zbatohen si në familje, ashtu edhe në shoqëri, duhet të mos shmangen nga drejtësia, dhe prej dijetarëve dhe udhëheqësve të mendimit pritet që të paralajmërojnë dhe të luajnë një rol ndriçues. Në këtë çështje, të gjithë duhet ta nxisin njëri-tjetrin, dhe ata që marrin vendime të gabuara duhet të paralajmërohen me një ton të butë.¹³

Yayınları, 2010, fq. 446.

11. Bediuzzaman Said Nursi, Lem'alar, İstanbul: Şahdamar Yayınları, 2010, fq. 236.

12. M. Fethullah Gülen, Prizma-4, İstanbul: Nil Yayınları, 2011, fq. 238.

13. Ebu Zehra, Zehretu't-Tefesir, Kajro: Daru'l-Fikri'l-Arabi, v. 3, 2002, fq. 1344.



Thyeria e zemrës

Pyetje: Thuhet se të thyesh zemrën e njeriut është më e rëndë sesa të shembësh Qaben. Cili është dënimi i atij që thyen zemrën e njeriut?

Përgjigje

Nuk kemi rastisur në ndonjë transmetim të saktë me tekstin "Të thyesh zemrën është si të shkatërrosh Qaben". Në një burim dytësor përmendet si hadith ky tekst: "Të thyesh zemrën e një myslimani dhe ta lëndosh atë padrejtësisht është mëkat më i madh sesa ta shkatërrosh Qaben 70 herë" (Mevlana Muhammed Rebhâmi, Rijad en-Nasihin). Por nuk ka burim të besueshëm.

Megjithatë, ka transmetime që tregojnë se kjo thënie nuk bie ndesh me parimet fetare. Sipas një transmetimi, Profeti ynë (a.s) duke shikuar Qaben tha:

"Pa dyshim, Allahu të ka bërë shumë të nderuar, të respektuar, shumë madhështore; por besimtari është më i respektueshëm se ti" (Ibn Maxhe, Fiten 2; Mexhma' ez-Zeuaid, 1/81).

Në një hadith tjetër thuhet: "Vlera e besimtarit tek Allahu është më e lartë sesa shkatërimi i tërë botës" (Nesai).

Duke marrë parasysh këto dhe hadithe të ngjashme, Mevlana Xhelaledin er-Rumi ka thënë:

"Qabeja është një ndërtesë e ndërtuar nga Halil Ibrahim (a.s), i biri i Azerit. Zemra është vendi ku Allahu i Madhëruar vështron. Për këtë arsye, të thyesh një zemër është më e keqe se të shkatërrosh një mijë Qabe." Allahu vështron në zemër, pra vlerëson sipas njiçit, sepse kështu shprehet

Profeti (a.s): "Allahu nuk ju shikon trupin/pamjen e jashtme, por shikon zemrat tuaja" (Muslim). Pra Allahu nuk ju vlerëson nga trupi/pamja e jashtme, por ju vlerëson sipas zemrës.

Në lidhje me dënimin e thyerjes së zemrës mund të themi, se sa virtyt i lartë është të gëzosh një zemër, por aq e rëndë është ta thyesh atë. Në këndvështrimin e besimtarit, të thyesh një zemër, nuk është thjeshtë të ofendosh, lëndosh apo trishtosh dikë. Sepse në zemër gjendet besimi. Zemra është shtëpia e besimit, e njohjes së Allahut dhe e dashurisë ndaj Tij. Zemra është një mineral i ndritshëm, i çmuar. Ajo ka dy aspekte. Njëri aspekt vështron botën shpirtërore dhe tjetri botën trupore/materiale. Nëse trupi fizik i njeriut drejtohet për nga shpirtërorja, zemra i përcjell trupit emocionet shpirtërore që merr përmes botës së shpirtit dhe bën që trupi të marrë frymë me paqe dhe qetësi. Pra zemra është aparati që transmeton rrezet e përshtatshme nga dimensionin shpirtëror në trupin material të njeriut. Sa e rëndë është të ndikosh për keq në këtë organ kaq të vyer të njeriut.

Në anën tjetër, kur një besimtar mysliman thyen zemrën dikujt që mbase ende nuk është njohur me besimin, e largon dhe e ftoh atë nga Islami. Kush i largon njerëzit nga Islami me qëndrimet dhe sjelljet e tyre janë njerëz të mjerë, që me të vërtetë shkatërrojnë zemrat. Edhe nëse këta nga pamja e jashtme janë njerëz të adhurimit, ata dëmtojnë reputacionin e Islamit në sytë e njerëzimit me gabimet që



bëjnë në marrëdhëniet, sjelljet dhe relatat me njerëzit. Me sa duket, duke thyer zemra pa pushim, në përgjithësi kjo kategori e myslimanëve e sheh veten në rrugë të drejtë dhe nuk pranojnë këshilla nga askush. Në fakt ky është thjesht një reagim për të refuzuar gabimet e tyre. Ndryshe thënë, ky është një tregues që në fakt zemrat e tyre janë të sëmura. Sepse ashtu si dashuria, edhe rrënjët e errëta të hipokrizisë, mendjemadhësisë dhe dashakeqësisë gjenden në zemër.

Për këtë arsye, ata që duan ta jetojnë Islamin në mënyrë ideale dhe të tregojnë bukurinë e tij – me gojë dhe me sjellje – duhet të marrin si udhërrëfyes të plotë ajetin dhe hadithin e mëposhtëm:

“Në saje të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj falua atyre gabimin, kërkoi falje Allahut për ata dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai.” (Al Imran, 3/159).

“Trim i fortë nuk është ai që rrëzon kundërshtarin e tij në tapetin e mundjes, por ai që e mposht veten në momentin e zemërimit” (Buhari, Edeb, 76; Muslim, Birr, 107-108).

Dhe Allahu na mëson këtë lutje: **اِنَّ بَوْلُقَ غَزَبْتُ اَلْ اِنَّ بَوْلُقَ** “Zoti Ynë, mos na i rrëshqit zemrat pasi t’na kesh udhëzuar” (Al Imran, 3/8).

Ndërkohë që Profeti (a.s) lutej ditë e natë: **بَلِّغْهُمُ اَيَّ مَهْلَلًا**

اِنَّ بَوْلُقَ غَزَبْتُ اَلْ “O Ti që i rrotullon zemrat sa andej këndeje, ma fikso zemrën në fenë tënde” (Tirmidhi, Kader 7, De’auat 90; Ahmed b. Hanbel, Musned 6/302).

Imam Rabbani ka thënë diçka të ngjashme në lidhje me temën:

Zemra është fqinji i Allahut Teala. Asgjë nuk është më afër me Allahun sesa zemra juaj. Nuk duhet lënduar zemra e askujt, qoftë besimtar apo mosbesimtar, sepse edhe fqinji mosbesimtar duhet mbrojtur. Duhet bërë shumë kujdes që të mos thyhet zemra. Pas mohimit nuk ka mëkat më të madh që e zemëron Allahun, më shumë sesa thyerja e zemrës. Sepse gjëja më e afërt me Allahun Teala është zemra. Të gjithë njerëzit janë robër të Allahut. Nëse robi i dikujt rrihet ose lëndohet, zotëria e tij sigurisht që do të zemërohet. Mendo pak madhëstinë, lavdinë dhe lartësinë e Atij që është Pronari i Vetëm i çdo gjëje. (Pra njeriu është nën tutelën e Allahut dhe mbrojtjen e Tij. Të lëndosh, ofendosh, zemërosh apo trishtosh dikë që është nën tutelën e Allahut, patjetër që do të shkaktojë zemërimin hyjnor.)

Allahu di gjithçka më së miri.

Këshilli i çështjeve fetare - insi.al

Fuqia e përfaqësimit në kumtimin e fesë



Kur një person i jetëson vlerat në të cilat beson dhe i bën vetë gjërat që thotë dhe shpjegon, quhet përfaqësim. Përfaqësimi është një nga cilësitë e rëndësishme të profetëve. Ata, jo vetëm që ua përçuan njerëzve zbuluesin që morën nga Zoti, por edhe e përfaqësonin atë në mënyrën më të mirë në jetën e tyre. Ashtu siç i mësuam njerëzit të adhuronin Allahun, ata gjithashtu jetësuan çdo pëllëmbë adhurimi dhe bindje në jetën e tyre. Përveç shpjegimit, përfaqësimi luajti një rol shumë të rëndësishëm edhe në pranimin e fesë që ata sollën në shoqëritë ku ata jetuan. Madje mund të thuhet se përfaqësimet e tyre vijnë përpara komunikatave të tyre. Sepse përfaqësimi është mjete më i rëndësishëm që njoftimi të arrijë qëllimin e tij. Prandaj, nëse ndjekësit e rrugës së profetit dëshirojnë që vlerat në të cilat besojnë të pranohen mirë nga bashkëbiseduesit e tyre, së pari duhet t'i përfaqësojnë në jetë.

Përfaqësimi i besimtarit duhet të jetë gjithmonë përpara mesazhit të tij. Ai duhet të jetojë dy ose tre herë më shumë nga sa thotë në jetën e tij praktike. Krenaria e Njerëzimit (a.s.) përjetonte në jetën e tij ndoshta dhjetëfishin e përgjegjësiave që u ofronte njerëzve. Për këtë arsye ai u premtoi besim njerëzve përreth tij dhe si rezultat i kësaj, fjalët që tha gjatën

pranim në ndërgjegjen e njerëzve. Edhe nëse jepni predikime me oratori dhe sinqeritet përsëri nuk mund të jeni aq bindës për ata që ju rrethojnë se sa fuqia në përfaqësim. Kurani thotë: "O ju që besuat! Pse thoni gjëra që nuk i keni bërë/nuk do t'i bëni!" (Surja es-Saff, 61/2). Ai u jep një paralajmërim të rëndësishëm besimtarëve me vendimin e tij. Në fakt, kjo nuk do të thotë "Mos thuaj gjëra që nuk i ke bërë". Përkundrazi, kjo do të thotë se "Nëse thoni diçka, atëherë jetoni dhe zbatojini ato në jetën praktike".

Përfaqësuesit e denjë të Islamit që kur i shikon të kujtojnë Allahun

Profeti ynë (s.a.s.) ka thënë në një hadith të tij se besimtar i vërtetë është ai që kur e shikon të kujton Allahun. Besimtari duhet të jetojë dhe të përfaqësojë të vërtetat në të cilat beson, në çdo mënyrë, edhe kur ulet e kur qëndron në këmbë, edhe me zemër e me trup. Pra, shkurtimisht, i përjeton dhe i përfaqëson të vërtetat e besimit në atë mënyrë sa që, atyrea që e shohin, u kujton Allahun. Sot, megjithëse ka shumë njerëz që lexojnë shumë dhe janë të ditur, numri i njerëzve që e jetojnë me të vërtetë atë gjë që besojnë është shumë i vogël. Njerëzit ndeshen me shumë pak shembuj të

kësaj natyre. Ata që duken si myslimanë, në të vërtetë nuk i reflektojnë në praktikën e tyre vlerat që thonë se besojnë. Megjithëse, thelbësorja është përfaqësimi i denjë.

Ju mund të parashtrooni sisteme filozofike shumë të përkryera. Mund të shkruani tekste letrare shumë tërheqëse. Mund të shkruani vepra të shumta për shkencën të ndryshme. Mund të bëni fjalime elokvente. Por nëse nuk i jetoni fjalët që dalin nga lapsi ose gjuha juaj, nuk mund të hyni në zemrat e njerëzve ose të jeni efektivë. Në fakt, deri tani janë paraqitur shumë utopi. Janë thënë shumë fjalë të zbukuruara, janë zhvilluar shumë filozofi, por sipas tyre nuk është formuar asgjë konkrete. Nga ana tjetër, mesazhi hyjnor i sjellë nga Krenaria e Njerëzimit (paqja qoftë mbi të) dha një shembull përtej asaj që përshkruhej në utopi, prandaj edhe ka vazhduar ndikimin e tij deri më sot. Madje, mesazhi i tij ende e bën të ndjehet vitaliteti edhe në shpirtat e sotëm të vdekur. Sepse ai ishte "usve-i hasene" një person shembull i mirë në çdo aspekt.

Të jesh i lakmueshëm

Ajo që shkaktoi humbjen e myslimanëve prej pesë shekujsh, në njëfarë kuptimi të tyre, është dobësimi i fuqisë së përfaqësimit. Megjithëse herë pas here u ngritën përfaqësues të fortë në epokën e hershme osmane dhe selçuke, ose në epokën eubite, zengite dhe ilhanite. Por këto nuk zgjatën shumë. Me kalimin e kohës, filloi një rënie dhe kështu, përfaqësimi i denjë hyri në kolaps. Kështu, përfundimisht myslimanët u shtypën nën rrënojat e tyre. Sipas fjalëve të Said Nursiut, ne jemi bërë "mezar-i muteharrik" – "njerëz të vdekur që ecin". Prandaj edhe efekti i Islamit humbi. Në këtë pikë, detyra jonë është të rigjallërojmë Islamin duke e jetuar atë në maksimum, pa kompromis dhe me të gjitha bukuritë e vërteta.

Ne nuk duhet të kemi turp për myslimanllikun tonë. Nuk ka asgjë të turpshme as në lutjet tona dhe as në namazet tona, as në mënyrën tonë të menduarit dhe as në atë çka ne besojmë. Të qenit në dialog me të tjerët, shtrëngimi i duarve dhe ulja në të njëjtën tryezë nuk duhet të dëmtojë përfaqësimin tonë. Së pari duhet t'i përvetësojmë në natyrën tonë bukuritë e fesë, të eliminojmë të metat tona nëse ka, dhe më pas t'i përfaqësojmë këto vlera që kemi në çdo mjedis. Pikërisht atëherë bëhemi bindës dhe u japim siguri bashkëbiseduesve tanë. Nuk duhet të harrojmë se një besimtar që përfaqëson denjësisht në praktikë fenë e tij, do të jetë më i efektshëm se një mijë oratorë dhe se një mijë figura të shquara letrare.

Nëse mendojmë se duke u dukur si të tjerët, do t'u dukemi të lezetshëm dhe do t'i bëjmë ata të na duan, gabojmë. Ata që veprojnë me këtë mendim do të goditen me të kundërtën e qëllimeve të tyre. Ne duhet të ndalojmë së qeni lakmues ndaj të tjerëve dhe të jemi lakmues ndaj vlerave tona Islame. Ne duhet të jemi të vendosur për të qenë vetvetja. Nëse mund ta arrijmë këtë dhe të përfaqësojmë siç duhet vlerat tona, e nëse sistemi ynë imunitar është i fortë, nuk kemi arsye pse të shqetësohemi për kontaktin me të tjerët.

Sinqeriteti në përfaqësim

Po, nëse duam që vlerat në të cilat besojmë të gjejnë vendin e tyre në zemrat e njerëzve, duhet të jemi në gjendje t'i përfaqësojmë ato siç duhet dhe të sigurojmë që ato të pasqyrohen në sjelljen tonë. Por edhe këtu nuk duhet të përfshihet artificialiteti dhe syfaqësia. Nëse nisemi me qëllimin për t'ua treguar anët tona të mira të tjerëve, efekti i përfaqësimit dhe sinqeriteti prishet. Gjëja kryesore në përfaqësim është mosnxjerrja në plan të parë të vetes. Nëse ka disa bukuri që na takojnë, kjo ndodh sepse ato dalin natyrshëm dhe sinqerisht nga veprimet dhe sjelljet tona.

Në disa raste, qëllimi e shuan sinqeritetin. Për shembull, përlësia dhe modestia janë ndër cilësitë më të rëndësishme që duhet të ketë një besimtar për sa i përket moralit të mirë. Por ajo që është e rëndësishme këtu në këtë pikë është se modestia duhet të vijë dhe të reflektohet natyrshëm në qëndrimet dhe sjelljet tona. Një person i tillë nuk ka nevojë të bëjë një përpjekje të veçantë për të qenë ose për t'u dukur modest. Kjo ndjenjë që ekziston brenda tij do të reflektohet automatikisht në sjelljen dhe veprimet e tij. Përndryshe, të bësh nijet që të tregohesh modest e shkatërron modestinë.

Njeriu duhet t'i përvetësoi të vërtetat në të cilat beson aq shumë sa të bëhen ngjyra dhe modeli i vërtetë i natyrës së tij, në mënyrë që ai të ecë gjithmonë në të njëjtën rrugë dhe të japë të njëjtat reagime. Në qëndrimin dhe sjelljen e besimtarit kuk duhet të ketë zigzage. Sepse besimtari përgjatë gjithë jetës së tij është në testim të vazhdueshëm nga njerëzit që e rrethojnë. Njerëzit vëzhgojnë me vëmendje sjelljen dhe veprimet tuaja për një kohë të gjatë dhe më pas ju vlerësojnë. Kini parasysh se edhe politeistët dëshmuar se Profeti ynë (paqja qoftë mbi të) ishte një person i besueshëm. Sepse ata kurrë nuk kishin parë ndonjë deklaratë të rreme apo sjellje të gabuar nga Profeti tek i cili ata ishin fokusuar derisa ai ishte dyzet vjeç. Përfaqësimi i përsosur i të Dërguarit të Allahut shkriu shumë zemra prej guri dhe shkëmbi, zbuti shumë zemra të forta dhe gjunjëzoi shumë njerëz rebelë.

Predikuesit dhe udhërrëfyesit e sotëm duhet të punojnë pa u lodhur për të bartur vlerat në të cilat besojnë në jetën e tyre dhe të jetojnë si monumente drejtësie dhe si heronj të dëlirësisë. Sepse njerëz që arrijnë një cilësi të tillë krijojnë besim dhe siguri tek ata që i rrethojnë. Kështu fjalët e tyre dëgjoohen dhe njerëzit që i shikojnë thonë me vete: "Këta njerëz mund të ndiqen". Prandaj dhe sot, edhe pse Islami nuk është i përfaqësuar denjësisht nga myslimanët, përsëri shohim se çfarë ndikimi ka tek bashkëbiseduesit. Nëse ai mund të përfaqësohet siç duhet, kush e di se si do të çlirohen zemrat e njerëzve. Nëse mund të heqim qafe gënjeshtat, hipokrizinë, sharjet dhe qëndrimet hipokrite, nëse i dëbojmë ato edhe nga ëndrrat dhe imagjinatat tona, dhe nëse mund të jetojmë një jetë të drejtë, lajmi i mirë i shpallur në suren "Nasr" do të shfaqet me të gjithë lavdinë e tij.

Tauland Bica

Ateizmi

dhe disa nga problemet e tij

Njeriu i turmës

Në mjaft raste të zhvillimit të spirales historike të shoqërisë njerëzore janë shfaqur fenomenet shoqërore totale. Në kuptimin e këtij nocioni natyrisht përfshihet e gjithë veprimtaria e një grupi shoqëror, e një apo e disa kombeve. Faktet kanë dëshmuar se në përshkrimin e kësaj spiraleje historike që thamë më sipër është shënuar si shkak kryesor shmangia e shoqërisë njerëzore nga e vërteta absolute, që është besimi në një Zot të vetëm. Pas kësaj shmangie shoqëria njerëzore historikisht është ballafaquar me degradim moral, me luftëra, me rënie ekonomike ose me instalim të formës së diktaturës në rrafshin politik etj. Megjithatë, ne do të flasim për idetë e gabuara të cilat janë prodhim i shmangies nga rruga e besimit në një Zot të vetëm sikurse thamë më sipër. Po ta vështrosh këtë problem në pikëpamje racionale, duket një problem i cili në esencën e tij nuk e meriton të quhet i tillë. Por në

qoftë se e vështrojmë duke u mbështetur në përvojën jetësore, pra, në mënyrë empirike, atëherë kjo çështje në realitetin e saj ka qenë, është dhe do të jetë problem i njeriut si individ, i shoqërisë si kolektiv, i kombit si tërësi dhe i njerëzimit si gjini njerëzore. Natyrisht kur shmangesh nga besimi i vërtetë, do të thotë të shmangesh nga Zoti, të shmangesh nga vetvetja dhe në fund të fundit do të thotë të shmangesh nga arsyeja e ekzistencës tënde në këtë botë. Atëherë, duke lënë pas rrugën e realizimit të identitetit njerëzor, në mënyrë të domosdoshme do të përqafojmë një rrugë tjetër, e cila nuk realizon identitetin njerëzor, por realizon shmangien nga ky identitet. Në mënyrë të koncentruar rrugët e shmangies nga identiteti njerëzor i kemi renditur në tre pika, si më poshtë: a) Të kuptuarit e gabuar të origjinës së vetvetes; b) Të kuptuarit e gabuar të ekzistencës dhe formimit të botës; c) Të kuptuarit e gabuar se



përse ekziston në këtë botë. Pra, në qoftë se këto tre pikëpamje i vlerësojmë totalisht me peshën reale të rëndesës së tyre në psikologjinë e njeriut, atëherë askush nuk mund t'i kundërvihet faktit se ato sjellin një deformim shpeshherë fatal në psikologjinë e tij. Ky deformim total i njeriut i cili përqafon absurden në vend të së vërtetës hyjnore, përqafon irealen në vend të reales, përqafon të përkohshmen në vend të së përhershmes, është shprehur deri tani me ngjyrat më të qarta në filozofinë ekzistencialiste të Sartrit ku ai shkruan: "Njeriu...në vend që të jetë një shkumë, një mbeturinë ose një lulëlakër...ai rastësisht është një njeri" (Jean Pol Sartre, Ekzistencializmi është humanizëm, fq.16-17). Ndërsa Joseph M. Bochenski shkruan përsëri duke iu referuar Sartrit në librin e tij (Ftesë për të filozofuar, fq.69) "Çdo gjë, thotë ai, -është e papërligjshme. Çdo gjë ekziston megjithëse është e panevojshme. Ekzistencën e sendeve, për

shembull të kësaj rrënje peme, nuk mund ta shpjegosh, atëherë ne biem në përfundimin logjik se çdo qenie, sidomos njeriu, është një ekzistencë absurde e pakuptimtë". Ne iu referuam Sartrit sepse ai është për fat të keq kulmi i ateizmit botëror. Mendojmë se me këto pak referenca, por substanciale që shkëputëm nga filozofia e tij, të kemi formuar në mënyrë mjaft të mjegullt, konturet e humnerës së tmerrshme të ateizmit. Megjithatë, të flasësh për ateizmin dhe labirintet e tij, mundësitë tona janë mjaft të varfra. Arsyeja është se ateizmi përfshin atë nocion që thamë më sipër dhe që quhet "fenomene shoqërore totale". Prandaj, ateizmi, si fenomen, paraqet një pafundësi temash dhe problemesh të cilat manifestohen nga njerëzit në të gjitha format praktike dhe subjektsh shpirtërore. Natyrisht këto forma shfaqen te njeriu në momentin kur ai arrin gjer në mohimin e ekzistencës së Krijuesit

të tij. Por, në të vërtetë çfarë është njeriu, përse ai është qenie e alternativës, përse nuk është njeriu një qenie stabile, që respekton në pikëpamjet e veta Krijuesin. Në lidhje me këtë le të flasim në mënyrë tepër sipërfaqësore për qenien me trup biologjik, por me një shpirt pafundësisht të larmishëm dhe me një botë e densitet të pafundmë ndjenjash të quajtur njeri. Në radhë të parë njeriun le ta shohim në vizionin filozofik "Natyra esenciale e njeriut kërkon lidhjen e tij me Zotin, pafundësinë. Gjendja ekzistenciale e tij është pasojë e tjetërsimit, thënë ndryshe e shkëputjes së tij nga Zoti. Prandaj, në qoftë se veprimet e njeriut e largojnë atë më shumë nga Zoti, tek ai bashkohen tjetërsimi dhe dëshpërimi. Kjo është arsyeja pse nuk ia vlen ta humbasim veten në një turmë, cilado qoftë natyra e turmës ose kolektivitet qoftë e pasur ose e varfër, ose politike në përbërje -në çdo rast thotë Kiekegard, - në vetë konceptin e saj turma është e pavërteta, për faktin se ajo e bën individin të papërgjegjshëm dhe pa pendesë ose të paktën dobëson ndjenjën e tij të përgjegjësisë duke e reduktuar atë në një grimcë" (Samuel E. Stumph, Filozofia, fq. 44). Në mbështetje të kësaj çfarë thotë Kiekegard le të shohim një sentencë homologe nga Erich Fromm në librin e tij "Psikonaliza dhe Feja" që thotë: "Njeriu për nga origjina e tij është kafshë kopeje. Veprimet e tij janë të përcaktuara nga motive instiktive për ta ndjekur pas udhëheqësin dhe për t'u ndodhur në një kontakt të ngushtë me kafshët që e rrethojnë atë (kupto njerëzit). Përderisa jemi të ngjashëm me delet, për ne nuk ka kërcënim më të madh sa ta humbasim këtë kontakt me kopenë dhe të gjendemi në vetmi. Më poshtë autori vazhdon - E mira dhe e keqja, e vërteta dhe gënjeshtra, të gjitha këto përcaktohen nga kopeja. Megjithatë, ne gjithsesi nuk jemi vetëm dele. Ne jemi gjithashtu edhe njerëz të pajisur me vetëdije dhe me arsye, të cilat për nga vetë natyra janë të pavarura nga kopeja". Më poshtë Fromm-i thekson se arsyeja është ajo çfarë e individualizon një njeri nga kopeja. Ajo fut sigurinë për veprimet dhe kërkesat tona shpeshherë dhe irracionale. Më poshtë ai e kundërshton një ide të tillë dhe bën fjalë për esencën e vetëdijes njerëzore. "Por përderisa ne jemi dele, as arsyeja nuk është udhëheqësi

ynë i vërtetë; ne udhëhiqemi prej një parimi krejt tjetër nga parimi i solidaritetit të kopesë". Në qoftë se përipiqemi të analizojmë këtë që thotë Fromm, duke u mbështetur në fakte historike ne themi se ai ka të drejtë. Origjina e këtij mendimi të Fromm-it mendojmë se është një derivat i konceptit të "ankthit" të filozofisë së Kiekegardit. Megjithatë, tani le të shohim se çfarë thotë Herderi. "Nuk ka asgjë absolute, por vetëm vlera rajonale dhe parime rrethore. Njeriu nuk është aspak nga të gjitha kohët, nga të gjitha vendet, por çdo periudhë historike dhe çdo kombi të rruzullit tokësor i përgjigjet një tip njerëzor specifik" (Alain Fienkielkraut, Disfata e Mendimit fq. 10). Ne do të thoshim se realisht në qoftë se shohim njeriun si subjekt psikik në evolucion në lidhje me kohën, me kombin dhe me mjedisin shoqëror ku ai jeton nga njëra periudhë historike, p.sh. mesjeta me tjetrën, do të thoshim me kushtet e sotme se njeriu ka evoluar. Njeriu i cili i përket periudhës së rendit skllavopronar, është i ndryshëm nga njeriu që i përket periudhës së rendit bujkrob ose mesjetar dhe ky i fundit është shumë i ndryshëm me njeriun e kohëve moderne. Ndryshimi do të thonim se konsiston në sferën e marrëdhënieve shoqërore, p.sh. në marrëdhëniet familjare, në pozicionin e burrit në marrëdhënien e tij ndaj gruas dhe fëmijës, në parimin e nderit (në të gjithë dimensionin dhe larminë e tij) në mënyrën e veshjes etj. Ndërsa esencialisht në psikikën e tij njeriu ka qëndruar dhe do të qëndrojë absolutisht i paprekur qëkur filloi të ekzistojë mbi tokë. Në lidhje me këtë do të flasim më poshtë. Megjithatë, në qoftë se ne e shohim motivin psikologjik të individit në turmë, në përgjithësi ai paraqitet në më shumë raste i ngjashëm me "delen" e Frommit dhe rrallë me ujkun që kërkon të dalë në krye të turmës. Ajo çfarë është esenciale në shkrimin tonë është se jeta në turmë udhëhiqet nga parimi i kaoticitetit dhe kënaqësisë së momentit. Në kaosin e veprimit individit i turmës shfryn instinktët e tij i motivuar nga parimi i kënaqësisë e trazuar kjo dhe me "justifikimin" e të qenët i pranuar në turmë. Turma është e kundërta e parimit të moralit individual. Individit duhet të shkrihet me turmën, domethënë të harrojë vetveten dhe në moralin e tij të vendosë përfundimisht etikën: se çfarë kërkon turma t'i përgjigjet

asaj, ose më mirë të themi ta imitojë atë në mënyrën e të sjellurit, në mënyrën e të veshurit, në parimet e moralit, në vlerat dhe në mënyrën e jetesës. Ose siç thotë Froomi: "Individi pushon së qeni vetvetja, përshtat për vete krejt tipin e personalitetit që i ofrohet nga modelet kulturore (kupto imitimi i yjeve të muzikës etj) dhe prandaj bëhet njëlloj si gjithë të tjerët, ashtu siç pretendojnë ata që të jetë. Hendeku ndërmjet "meje" dhe botës zhduket. Ky mekanizëm, -vazhdon Froomi, -mund të krahasohet me ngjyrimin mbrojtës që marrin disa kafshë. Personi që heq dorë nga uni i tij individual dhe që bëhet automat identik ndër miliona automatë të tjerë që e rrethojnë, nuk duhet të ndihet më i vetmuar dhe i ankthshëm, por çmimi që paguan është i lartë, është humbja e unit të tij" (Erich Fromm, Arratisje nga liria, fq.141).

Pra, me pak fjalë, njeriu humbet vetveten, humbet personalitetin e tij dhe hidhet në vorbullën e turmës. Tani le të shohim në mënyrë mjaft të shkurtër raportin e njeriut të turmës me institucionet. "Autoriteti abstrakt i një institucioni i shprehur nëpërmjet rregullash, na lejon të konformohemi ose të rebelohemi, ose që të dyja së bashku; vullnetit të pakuptueshëm të një individi tjetër zakonisht mund të shkohet pas vetëm nëse kemi të bëjmë psikologjikisht me varësi, përrulje, vetëposhtërim. Më poshtë autorët shpjegojnë arsyen se - ideja e shtypjes vjen e ngjizet vetëm kur njerëzit fillojnë të dyshojnë se rregullat institucionale abstrakte fshehin thjesht vullnetin e huaj vetjak. Kjo përbën nocionin elementar apo thelbësor të tiranisë apo të sundimit arbitrar" (Filozofia dhe tranzicioni, Gaspar M. Tomas, Ferenc Feher, Agnesh Heler fq. 4). Por lind pyetja, përse njeriu bashkohet me turmën ose ta themi ndryshe, sipas filozofëve idealistë, përse njeriu është një qenie shoqërore dhe bashkohet në pjesëmarrjen shpirtërore të kolektivit njerëzor? Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje nuk mund të mjaftojë vetëm një artikull, sepse problemi është shumëplanësh, por në mënyrë tepër substanciale po japim dy arsye madhore, të cilat janë shtysa e domosdoshme për individin për të qenë anëtar i turmës: 1. Plotësimi i nevojave për ekzistencë; 2. Plotësimi i nevojave psikologjike.


Në rast se njeriu do të kishte fatkeqësinë t'i shmangej kolektivit njerëzor, atëherë ai do të ballafaqohej me fenomenin e Robinson Kruzo-së. Por e keqja e njeriut të perëndimit qëndron në atë se a është lënë Evropa pa një kod moral? Nuk është puna se njeriu i turmës ka flakur tej një kod tashmë antik për ta ndryshuar atë me një kod të ri, por se në qendër të skenës së jetës së tij është vënë përpikmërisht ajo aspiratë për të jetuar pa iu përshtatur asnjë kodi moral...kur njerëzit flasin për një moral të ri, ata thjesht i përkushtohen imoralitetit të ri. Prej këtej del -thekson më poshtë Jose Gasset- se do të qe vërtetë naive ta akuzosh njeriun e së sotmes për mungesën e një kodi moral, sepse kjo akuzë do ta tregonte të ftohtë ose më tepër do ta lajkatonte atë. Kjo për shkak se amoralizmi sot është shndërruar në diçka të zakonshme saqë cilido e kushdo ngre lëndata në qiell për ushtrimin e tij" (Jose Ortega Gasset, Revolta e turmave, fq.237).

Atëherë kush jam unë, kush je ti në turmën e pafundme të njerëzve të perëndimit? Unë dhe ti jemi ata të cilët atë çfarë e quanim të shenjtë dje, sot e hedhim poshtë me përbuzje. Nga ana tjetër as që e ndiejmë se kemi hedhur poshtë një parim të moralit, një tabu të nderit apo atë që është esenca e realizimit të identitetit njerëzor: besimin në Zot, dhe as që duam të kthejmë kokën pas dhe ta ndiejmë atë që mohojmë çdo ditë, atë çfarë deformatim çdo ditë, atë çfarë gënjejme dhe mashtrime vetveten dhe të tjerët çdo ditë.

Ne nuk duhet ta lëmë vetentë shndërrohemi thjesht në subjekte të veprimit kaotik me bazë psikozën e interesit të momentit, apo të veprojmë duke u mbështetur mbi pramin e kënaqësisë dhe të vetafirmimit me çdo formë dhe mjet. Njeriu i turmës me bindje ateiste është ajo qenie që lëviz së bashku me turmën drejt një degradimi moral të domosdoshëm dhe drejt një deformimi dhe gjymtimi të paevitueshëm të identitetit njerëzor. Duke menduar se është stërnip i kërmillit dhe pasardhës i majmunit, njeriu i turmës nuk ka pse të ketë ndonjë ideal në këtë jetë...

Brahim Ramja

Pasqyrimi i botës shpirtërore në letërsinë dhe artin e realizmit socialist



Në vitet e diktaturës komuniste, në kuadër të kornizës ideologjike brenda së cilës duhet të ishte gjithçka, arti dhe letërsia nuk bënë përjashtim. Veprat letrare plot skematizëm partiak përpiqeshin të pasqyronin realitetin dhe mirëqenien që gjoja ekzistonte brenda orbitës së vendeve socialiste. Në to himnizohej lufta e partisë komuniste shqiptare për çlirimin e vendit nga pushtuesit fashistë dhe ndërtimin e tij. Në kohezion me politikën e shtetit ateist shqiptar në këto vepra letrare lufta kundër fesë ishte pjesë e rëndësishme e direktivave që institucionet partiake lëshonin herë pas here.

Denigrimi i figurës së klerikut, paraqitja e tij si një mashtrues dhe qesharak ishin subjekte të preferuara për romane, novela dhe skenarë filmash. Sistemi arsimor shërbente si një laborator gjigant ku vepra të tilla letrare sintetizoheshin në kuadër të programit mësimor, duke injektuar dhe indoktrinuar kështu gjeneratat me një fobi patologjike apo antipati për fenë.

Fraza të tilla si "Kaurin e jaratisi Allahu për t'i bërë hyzmet turkut", "haxhi në Qabe e shejtanët në hejbe hafizi ynë", apo paraqitja e klerikut si njeri me vese e moral të dobët, bënë pjesë në arsenalin artistik që partia përdorte në luftën propagandistike kundra fesë. Pas nuk qëndronte as kinematografia, "prej të gjitha arteve për ne filmi është më i rëndësishmi" - theksonte Lenini, ndonëse sipas një studiuesi filmi është më pak art se të gjitha fenomenet që mbajnë këtë emër. Në të vetmin televizion kombëtar që ekzistonte në ato vite filmat shpeshherë edhe po të mos kishin si subjekt të drejtpërdrejtë denigrimin e fesë apo klerikut, pasazhet ku hoxha apo prifti portretizoheshin si role negative nuk mungonin. Dashur pa dashur në subkoshiencën e individit imponohej kështu përdhunshëm një sentiment negativ për religjionet në përgjithësi.

Poezia e zhveshur në maksimum nga vlerat religjioze të krijonte bindjen se njeriu si krijesë ishte produkt i fabrikave, tëpërkë si një detal të cilit partia i kish dhënë formën në bazë dhe të funksionit që ai do të kryente. Utopia, uniformiteti dhe zbrazëtia që vërehet në krijimtarinë letrare të realizmit socialist, nuk arriti të bëhej ushqim shpirtëror për individin, përkundrazi, ajo synonte formësimin e njeriut mesatar. Në jetën reale ajo shikonte të përgjithshmen, anën sasiore, në kundërshtim me artin për të cilin pranë njeriut ekziston njeriu dhe jo turma.

Në çdo institucion kulturor, arsimor, fabrikë apo shesh qyteti, bustet e klasikëve të marksizëm-leninizmit dhe diktatorit rrezatonin fuqishëm dhunën mbi ndërgjegjen e individit, duke iu kujtuar atyre se ne jemi të pavdekshëm dhe ju të detyruar të na bindeni. Të heshtur dhe krenarë, skalitur mbi mermerin dhe bronzin e ftohtë, ata kërkonin të evokonin jo më kot një epokë, që në histori njihet me emrin epoka e faraonëve. Skulptorët dhe soji i tyre nuk reshtnin së punuari natë

e ditë, sepse në të gjitha vendet e boshtit komunist panairi më i madh kulturor ishte panairi i idhujve. Si në lashtësi këto "perëndi" të dhunës nuk hezituan të ngrinin piramida në mes të qytetit apo të balsamosnin trupat e tyre pas vdekjes. Për herë të parë në historinë botërore, në qytetin e Shkodrës, më 9 qershor 1973 u ngrit Muzeu Ateist me gjashtë seksione. Nëse ka vepër më paradoksale e cila mund t'i identifikojë komunistët shqiptarë nga ata të vendeve të ndryshme të botës për këtë mund të shërbejë pikërisht ky muze.

Edukimi letrar-artistik përçonte tek lexuesi apo shikuesi mesazhe se si njeriu nën shembullin e heroit komunist duhet të ishte besnik ndaj partisë, shtetit dhe kolektivit i cili shpeshherë ndërhynte në jetën e individit pa i lënë atij asgjë personale. Raporti mes vetjakes dhe kolektivës nuk kishte kufij, edhe morali, si vlera më e çmuar e njeriut, nuk ishte i pasakrifkueshëm, nëse këtë e lypte partia dhe eprori. Nëse kishte një tempull nën të cilin rrezet e artit mund të përçonin diçka ndaj botës shpirtërore të njeriut ky ishte teatri, megjithëse frika nga satira e bënte diktaturën të druhej përpara tij. Aty njeriu brenda një harku të shkurtër kohor vërente se si jeta e çdo personazhi kalonte midis mundimeve të shumta, dhe si përfundim, zgjidhej apo nuk zgjidhej konflikti, jeta shpalohej si një dramë e cila ngacmonte dhe ngjallte tek ai ndjesinë e shpirtit dhe të një bote përtej realitetit material. Nuk kanë thënë kot se në mungesën e objekteve të kultit, teatri është një tempull ku njeriu vëren ekzistencën e botës nga një prizëm tjetër.

Një aspekt tjetër ku pasqyrohet varfëria shpirtërore e artit të realizmit socialist janë ndërtimet arkitekturore. Qendrat urbane s'ishin gjë tjetër veçse një grumbull ndërtesash uniforme, të shkreta, justifikimi se kjo vinte për shkak të nevojave të mëdha dhe mjeteve të pamjaftueshme, nuk vlen. Veç kësaj, shkatërrimi i objekteve të kultit shënon aktin më kriminal që komunistët kryen karshi kombit. Kishat, xhamitë dhe teqet, përfshirë aspektin dhe rëndësinë shpirtërore që ato kishin, përfaqësonin nga ana tjetër një pasuri të paçmueshme arkitektonike. Dehumanizimi dhe zhveshja e gjithçkaje nga aspekti religjioz solli si rezultat një atmosferë asfiksuese për vetë individin dhe shoqërinë.

Si përfundim i pasqyrimin të botës shpirtërore në letërsinë dhe artin e kohës së diktaturës, pothuajse nuk iu kushtua aspak rëndësi fesë, përkundrazi, arti dhe letërsia shpeshherë u përdorën për ta luftuar religjionin, edhe aty ku shkrimtari ishte i detyruar të përshkruante personazhin me aspektin metafizik që ka çdo njeri, vepra quhej reaksionare. Një censurë e tillë buronte nga parimi se: në ateizmin e dhunshëm, arti zëvendëson religjionin e dëbuar.

Ura e Xhenetit

Kështu do të më pëlqente ta quaja unë veprën më të re të pensionistit bamirës, Mensur Shehu nga Dohoshishti i Dibrës. Ai tashmë i ka kaluar të tetëdhjetat dhe ka hyrë në dekadën e parafundit të shekullit, por punët e tij të mira shtohen e shtohen, sikur duan të garojnë me vitet e këtij njeriu.

Mensur Shehu ka pasur një jetë të gjallë e aktive, duke punuar në ndërmarrje të ndryshme të rrethit e më pas në spitalin e Peshkopisë, derisa doli në pension në vitin 2004. Shihte përditë pensionistë që dilnin nga fshati, që dilnin ta pinin kafen në qytet. Jo, Mensuri nuk donte t'u përngjante atyre, nuk donte të ishte si ata. Në kokën e tij po bluheshin projekte, që për mundësitë e tij të vogla financiare, dukeshin dhe në fakt ishin gjigande.

Nuk kaloi as dhe një vit nga pensionimi, kur realizoi veprën e parë të bamirësisë, një çezëm për nxënësit e shkollës. Do ta quanim të parën për nga përmasat, pasi gjithë jeta e këtij njeriu fisnik është një zinxhir i gjatë bamirësie. Kur shihte fëmijët, që pinin nga uji i çezmës dhe lanin klasat me të, ai e harroi lodhjen dhe mundin që kishte bërë, apo shpenzimet jo të pakta që kishte kryer. Ju duk se gjeti një mënyrë të re për të mposhtur mplakjen dhe plogështinë, ndaj u betua, që kësaj rruge nuk do ti ndahej, sa të kishte jetën në vazhdim.

Në të njejtën mënyrë punoi për të bërë krahët anësore të urës, që ndodhej mbi përrua, në mesin e fshatit. Sa e sa veta kalonin aty, dhe as që u binte ndërmend të bënin një gjë të tillë. Madje mund të kishte dhe biznesmenë, që

i kalonin me qindra herë të ardhurat e tij të pakta. Por jo gjithmonë pasuria matet me para, mvaret shpirti a është mjaftueshëm i pasur për të rrokur vepra bamirësie, që e lartësojnë atë.

Pak vite më parë, në kohën e pandemisë, ai mendoi të shkojë në haxh për herën e tij të dytë. E kishte kryer për vete në vitin 2012 e tani donte që ta bëjë për prindërit e tij. Siç e dimë të gjithë, gjërat u bllokuan, puna, lëvizjet e çdo gjë tjetër. Meqë nuk po shkonte në Haxh, të paktën të shkonte tek varrezat e të bënte një dua për prindërit e tij. I mbaroi ritet, lutjet tek Zoti i Gjithësisë, por gjendja e varrezave nuk i pëlqeu. Kafshë të ndryshme, dele, dhi e lopë hynin e dilnin aty për të kullotur. Mungonte një rrethim dhe Mensuri mendoi, se mund ta realizonte një gjë të tillë. Të paktën të prehen të qetë, pa i shqetësuar dikush nga bota e të gjallëve.

Si në çdo projekt tjetër, Sheh Mensuri bëri preventivin dhe filloi nga puna. Arriti t'ia dalë mbanë dhe pse kovidi e mbërtheu për disa javë. Ai nuk e di se sa vlerë ka një punë e caktuar, vetëm Zoti e di. Po ndoshta me rrethimin e varrezave që bëri, ai e ka realizuar haxhillëkun e dytë, që do të bënte për nënën dhe babain e tij.

Kur mbaroi këto tre bamirësi, që përmendëm, mendoi se e treta do të ishte dhe e fundit. Por populli thotë, që oreksi vjen duke ngrënë. Sërish mendja e tij punonte për diçka të re, për projektin e tij të rradhës. Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit, tha sheh Mensuri, do ta bëjë dhe një punë të katërt. Zoti më dha jetën e shëndetin dhe



unë do ta bëj për hatër të tij. Në fakt, kishte kohë që po e piketonte atë me kujdes.

Aty në të dalë të fshatit, ishte një tjetër përrua, ai që vinte nga fshati i Grevës. Verës nuk kishte ujë, por në disa periudha të vitit bëhej i rrëmbyer. Fshati i tij kishte mjaft tokë bujqësore matanë, pa folur për kullota e zabele, që ishin pa hesap. Banorëve u duhej të dilnin shumë herë në anën tjetër të përroit, për të punuar e për të sjellë që andej prodhime të ndryshme bujqësore. Shpesh kalonin me vështirësi përmes ujit dhe baltovinës së krijuar. Sheh Mensuri mendoi që të ndërtojë një urë për bashkëfshatarët e tij. Një urë, ku banorët të kalonin normalisht, pa u stresuar dhe pa u penguar. Ndoshta kjo urë e ndërtuar në këtë dynja, mund të shndërrohej në një urë për të në ditën e Gjykimit, për të hyrë në xhenet.


Ai e filloi punën në prill të këtij viti. Terreni ishte mjaft i thyer dhe transporti i materialeve shumë i vështirë. Duheshin mbi 20 kunjtalë çimento, disa makina rërë, shumë të tilla me gurë. Deri diku ata i dërgonte me një kamionçinë, apo zetar. Më tej duheshin dhe 250 metra larg për tu përcjellur me një karrocë dore. Mbi 700 karroca gurë i lëvizi vetë drejt vendit ku do të bënte punimet. Njeriu bamirës, megjithë moshën e shtyrë i bënte të gjitha proceset vetë, rolin e ustait, të ndihmësit, transportuesit, projektuesit e supervizorit. Padyshim që në këtë mori të vogla shërbimesh dhe financimi ishte i tij. Kur ata njerëz, që kishin tokë e pronë matanë

përroit nuk bënin angazhime, njeriu që nuk kishte lidhje fare me atë tokë, bënte përpjekje titanike.

Dy vjet zgjati ideimi i projektit dhe gjashtë muaj realizimi i tij. Në përfundim të veprës së katërt të bamirësisë, sheh Mensuri shtron një drekë domethënëse. Ka bërë dhe një përkujtesë për prindërit e tij të vdekur. Ky përkujtim dhe këto vepra bamirësie shkojnë dhe për të afërmit, që kanë ndërruar jetë. Isha i ftuar dhe unë, miku i tij në këtë drekë dhe së bashku lutëm Zotin, që duatë tona të ishin pranuar, që prindërit e tij të ishin banorë të xhenetit dhe bamirësitë e këtij njeriu të mos kishin të sosur.

Gjithmonë, kur përfundon një projekt, hidhen sytë matanë nga objektivi tjetër. Sheh Mensuri ka në mendje një vepër tjetër bamirësie, por akoma nuk i ka zbuluar detajet. Në të tilla raste një frikë e vogël e bren në mendje. Ai nuk ka frikë nga vdekja, se e di që një ditë ajo do të ndodhë. Frika e tij është, se mos vdekja e gjen në mes të veprës së bamirësisë dhe i ngelet ajo në mes. Sidoqoftë, dhe kësaj ja ka gjetur anën. Porosit familjarët dhe të afërmit ta përfundojnë atë vepër, nëse ai ka ndërruar jetë, duke j'ua lënë amanet. Ai le garanci për këtë çdo pasuri që ka, deri te shitja e tokës. Nuk do marrim asgjë nga kjo botë, thotë ky njeri bamirës, përveç punëve tona të mira.

Zoti të dhashtë jetë të gjatë sheh Mensuri, o njeri fisnik dhe t'u shtofshin sa më shumë punët e bukura në dobi të njerëzimit!



Cilësitë e tiparet
**E ATYRE QË ISHIN TË
DENJË PËR POZICIONIN
E KALIFATIT**

Pikëpamjet e Ebu Bekrit (r.a.) lidhur me këtë çështje

Asimi na tregon se: "Ebu Bekri (radijallahu anhu) ishte sëmurur dhe u urdhëroi atyre që kishte pranë që të mblidheshin njerëzit dhe atë vetë ta ngjitrnin në minber, sepse kishte për t'u thënë njerëzve disa gjëra. Kjo ishte edhe hutbeja e fundit e Ebu Bekrit. Lëvdoi dhe përgëzoi emrin e Allahut, pastaj mbajti këtë fjalë të bukur:

- "O njerëz! Druhuni prej botës, mos i besoni asaj, sepse ajo është gënjeshtare. Zgjidhni më mirë ahiretin sesa këtë botë; atë të doni ahiretin. Dhe ta dini se dashuria për njëren syresh do të thotë neveri për tjetrën. Gjykimi për mbylljen e kësaj çështjes së kalifatit që na është vënë mbi supë e duhet ta zgjidhim, do të varet edhe nga fakti se sa e shëndoshë do të jetë në krye ajo çështje. Për këtë arsye, detyrën dhe misionin e vështirë të kalifatit duhet ta marrë përsipër ai që është më i forti ndër ju, ai që ka më shumë kontroll mbi veten, ai që është më i vendosuri, kur duhet përdorur forca, e ai që është më i buti, atëherë kur duhet vepruar me butësi e delikatesë, ai që di më mirë se si të përftojë dobi edhe nga mendimet e të tjerëve, që janë të aftë për të gjykuar e për të dhënë mendim; detyrën ta marrë përsipër një njeri që nuk merret me punët që nuk kanë të bëjnë me të, që nuk ka turp të mësojë rreth atyre gjërave që ai vetë nuk i di, që nuk e shushatin ndodhitë e papritura që ia behin, që di ta ruajë plaçkën e të tjerëve, që nuk nxehet e si pasojë e nevrikosjes të tradhtojë atë që i është lënë si amanet, për ta ruajtur, që nuk ka mangësi në largpamësi e që di ta kuptojë se si do të jetë e ardhmja pas çdo vendimi të marrë dhe që cilësi kryesore të vetën ka të vepruarit çdoherë me maturi dhe që i frikësohet pa masë mosbindjes ndaj urdhrave të Allahut. Dhe ai që i mishëron të gjitha këto cilësi është Omeri!"¹

Çfarë mendimi kishte Omeri (r.a.) lidhur me këtë?

Na e tregon Abdullah bin Abasi (radijallahu anhu) se: "Unë i kam shërbyer Omerit (radijallahu anhu). Kisha shumë respekt për të dhe e çmoja shumë si njeri. Një ditë shkova në shtëpinë e tij. Omeri (radijallahu anhu) ishte vetëm, në dhomën e tij. Psherëtiu aq fort, sa që mendova se i doli shpirti nga vendi. Pastaj ngriti kryet lart dhe mori njëherë frymë thellë-thellë. Unë mblodha gjithë forcën brenda

vetes dhe me vete po thosha:

- "Uallahi, do ta pyes se pse psherëtiu ashtu." Dhe ashtu bëra, e pyeta:

- "O Prijësi i Besimtarëve, uallahi, do të më thuash, çfarë ta shkaktoi atë frymëmarrje ashtu thellë? Çfarë shqetësimi të mundon, që psherëtime aq fort?"

- "Po, shqetësimi më bëri të psherëtij; dhe ç'fatkeqësi se! Nuk po gjej që nuk po gjej dot dikë për t'i lënë amanet këtë misionin e epërm të kalifatit. Ka gjasa që edhe ti do të më thuash se më i denji për këtë detyrë është Aliu, të cilin ti e do aq shumë.", - m'u përgjigj ai.

- "O Prijësi i Besimtarëve! Po pse, për ju a nuk është Aliu ai që e meriton më së shumti kalifatin, duke pasur parasysh mënyrën se si ai mërgoi, që ai ka qenë i pranishëm thuajse në të gjitha bisedat me të Dërguarin e Allahut dhe, për më tepër, ai është edhe nga familja e tij?"; - vijova ta pyesja unë.

- "Po, ashtu është, e vërtetë. Mirëpo është shumë shakaxhi. Dhe këtë detyrë mund ta përballojë vetëm dikush që di të tregohet i butë pa u shfaqur i dobët, që di të tregohet i rreptë duke iu shmangur dhunës, që sillet bujar pa rënë në shpërdorim dhe që di se si të jetë i matur pa u treguar dorështrënguar.", - tha ai, duke shtuar:

- "Këtë punë mund ta përballojë e ta kryejë me sukses vetëm një njeri që nuk i përulet askujt, që i shmanget dyfytërsisë, që nuk shkon pas dëshirave të veta, që në vend se të flasë shumë hyn menjëherë në veprim, që nuk devijon nga ajo që është e drejtë, qoftë edhe kundër të afërmeve të vet, që di ta ruajë nderin e që nuk e mohon atë as kur është fare vetëm."²

Ndërsa, në një tjetër transmetim, të cilin na e përcjell Selman Farisiu (radijallahu anhu), ai na tregon se si Omeri (radijallahu anhu) i ka thënë:

- "Çfarë jam unë, mbret, apo kalif?"; - më pati pyetur.

- "Nëse ti merr nga toka e myslimanëve taksë qoftë edhe një dirhem më pak ose më shumë dhe nuk e vendos aty ku duhet, atëherë ti nuk je më kalif, por mbret!"; - i qeshë përgjigjur unë.

Kjo përgjigje e Selmanit e pati prekur shumë Omerin (radijallahu anhu) dhe e pati futur në të thella, duke e bërë të mendohej gjerë e gjatë për veten."³

2. El-Hindi, *Kenzu'l-Umma*/5/907 (14255).

3. El-Hindi, *Kenzu'l-Umma*/12/800 (35805).

1. El-Hindi, *Kenzu'l-Umma*/5/879 (14183).

Drejtëshimi i butësisë me ashpërsinë të një kalif

Said bin Musejebi (radijallahu anhu) tregon: "Kur detyra e kalifatit iu kalua Omer bin Hatabit (radijallahu anhu), ai u ngjiti në minberin e të Dërguarit të Allahut; pasi lëvdoi dhe përgëzoi Allahun e Madhërishtëm, ai mbajti edhe një fjalë përpara besimtarëve:

-“O njerëz! E di, jo pak herë ju më keni parë mua të sillem i ashpër dhe disave prej jush mund t’u jem rënduar jo pak. Shkaku i të gjitha sjelljeve të mia ka qenë ky: unë kam qenë me Resulullahun e dashur; unë kam qenë një shërbëtor i tij. Ai ishte ashtu siç e përshkruan edhe Allahu i Lartësuar në ajetin e njëqindnjëzetetë të sures “Teube”, ‘i dhembshur dhe gjithë mëshirë ndaj besimtarëve’. Ndërsa unë, krahasuar me të isha si një shpatë e nxjerrë nga brezi. Po të mos më vendoste ai në mill, apo po të mos ishte ai që të më pengonte nga të bërët e ndonjë veprimi, isha unë ai që u jepja njerëzve mësimin e merituar, duke qenë se ai ishte shumë i butë. Derisa vdiq Resulullahu, ky ka qenë pozicioni im pranë tij. Dhe ai u largua nga kjo botë shumë i kënaqur prej meje. Pafundësisht lëvduar qoftë Allahu, e unë jam shumë i kënaqur për këtë. Edhe më pas, të njëjtin pozicion e mbajta edhe pranë kalifit të të Dërguarit të Allahut, Ebu Bekrit (radijallahu anhu). Ju e dini se sa bujar, sa i fisëm dhe se sa i butë ishte ai si njeri. Edhe pranë tij u gjenda si ndihmës. Unë isha si një shpatë e tij. Butësia e tij dhe ashpërsia ime plotësonin një të tërë. Po të mos më pengonte ai, Ebu Bekri (radijallahu anhu), që unë të tërhiqesha,

unë hidhesha menjëherë në sulm. Pra, këtë pozicion kam pasur edhe pranë Ebu Bekrit (radijallahu anhu), derisa Allahu i Madhërishtëm ia ndau shpirtin prej trupit. Edhe ai u largua nga kjo jetë i kënaqur me mua. Lëvduar qoftë Allahu, se edhe kjo është diçka që më bën të ndihem fatlum.

Kjo detyrë për t’ju prirë ju sot m’u kalua mua. Unë e di fare mirë, se disa prej jush do të thotë: ‘Ky nuk ishte kalif dhe sillej shumë ashpër me ne; imagjino tani, që u bë kalif, kushedi se sa i egër do të jetë me ne!’ Nuk ka nevojë të pyesni askënd për mua, ju më njihni dhe më keni provuar vetë. Me aq sa di unë, ju e dini mjaft mirë edhe sunetin e Profetit tuaj dhe rrugën e ndjekur prej tij gjatë gjithë jetës. Sot unë nuk kam asnjë çështje, për të cilën të ndihem i penduar, ‘që pse nuk e pyeta Resulullahun tonë të nderuar!’; sepse unë atë kam pyetur për çdo gjë. Ta dini mirë, se, ajo ashpërsi që keni vërejtur tek unë deri më sot, që nga çasti që jam caktuar si kalif mbi të gjithë besimtarët, është shumëfishuar edhe më shumë, derisa të vë në vend të drejtat e myslimanëve që janë të dobët e të pafuqishëm e t’u tregoj vendin të gjithë atyre që i kanë shkelur këto të drejta. Por, krahas kësaj ashpërsie, unë do t’i përullem gjer në tokë të gjithë juve që jeni të ndershëm, që u qëndroni larg të këqijave dhe që u bindeni me përpikëri urdhëresave të Allahut. Nëse bie në kundërshti apo do të kem mosmarrëveshje me ndonjërin prej jush, unë nuk druham aspak që të shkoj vetë tek ai që pretendon ndonjë të drejtë prej meje (për verifikim). Andaj, kushdo prej jush që do të ketë ndonjë problem me mua, apo ndonjë



çështje për t'u zgjidhur, të mos ngurrojë, por t'i kërkojë me ngulm të drejtat e tij.

O robt e Allahut! Kini frikë e mos ngrini krye ndaj Allahut. Mos m'u bëni mua pengesë në punët e mira që do të bëj, por më ndihmoni, sepse kjo është edhe në interesin tuaj. Më ndihmoni që të jem sa më i drejtë në realizimin sa më mirë të kësaj detyre të udhëheqjes, që Allahu më ngarkoi mbi supe, që t'i urdhëroj njerëzit në të mirë dhe t'i pengoj ata nga çdo keqbërje!⁴

Ndërsa Muhamed bin Zejdi (radijallahu anhu) tregon: "Një ditë, Aliu, Osmani, Zubejri, Talhaja, Abdurrahman bin Aufi dhe Sadi (radijallahu anhu), u mbledhën në një vend. Në mesin e tyre ai që mund të fliste më lirshëm me Omerin (radijallahu anhu) e nderuar ishte Abdurrahman bin Aufi. Ata i kërkuan atij:

- "Abdurrahman, sikur të shkoje njëherë tek Prijësi i Besimtarëve e të flisje me të dhe t'i thuash: Njerëzit nevojtarë po vijnë deri tek ti; mirëpo nga druajtja prej ashpërsisë sate nuk arrijnë të ta tregojnë dot se çfarë problemi kanë, kështu që kthehen pa e zgjidhur problemin që kanë." Abdurrahman bin Aufi shkoi menjëherë tek Omeri (radijallahu anhu) dhe i tha:

- "O Prijësi i mbarë Besimtarëve! Duhet të tregohesh më i butë me njerëzit, sepse shumë njerëz që kanë ndonjë nevojë vijnë këtu, deri tek ti, mirëpo, druhen dhe ikin pa ta treguar dot se ç'problem kanë."

- "Shiko, o Abdurrahman.", - i tha atij Omeri (radijallahu anhu), - "më thuaj, për hir të Allahut, kush të dërgoi ta flasësh këtë me mua, Aliu,

4. El-Hindi, *Kenzu'l-Umma*/5/879 (14184).

Osmani, Talhaja, Zubejri dhe Sadi?"

- "Kam Zotin dëshmitar, ata më dërguan.", - ia priti Abdurrahmani.

- "Uallahi, Abdurrahman, në fillim u përpoqa të tregohesha shumë i butë me njerëzit; madje aq tolerant fillova të tregohem, sa që fillova të kem frikë nga Allahu. Kësisoj, nisa të sillem sërish me autoritarizëm. Dhe tani kam filluar të kem frikë nga Allahu për ashpërsinë me të cilën po sillem me njerëzit; më thuaj ti një rrugëdalje, si t'ia bëj?"

Abdurrahmani, pasi mori këtë përgjigje, u ngrit menjëherë në këmbë, kishte filluar të qante. E tërhoqi zvarrë rrobën që kishte hedhur mbi trup dhe teksa ishte duke dalë thoshte:

- "Mjerë ky popull kur të vdesësh edhe til Mjerë gjendja e këtyre njerëzve kur ti të mos jesh më!"⁵

Sipas transmetimit të Sha'bit, Omeri (radijallahu anhu) ka thënë kështu:

- "Uallahi, për hir të pëlqimit dhe të kënaqësisë së Allahut mua zemra më zbutet aq shumë, sa që më duket më e butë edhe se ajka e qumështit. E po prapë, po për hir të pëlqimit dhe të kënaqësisë së Allahut, ajo më ashpërsohet aq shumë, sa që më e duket më e ngurtë se guri."⁶

**Shkëputur nga libri "Jeta e Sahabëve 1"
M. Jusuf Kandehleui
Botim i KMSH**

5. El-Hindi, *Kenzu'l-Umma*/12/788 (35770).

6. Ebu Nuajm, *Hijje* 1/51.



DESTINIMI I NJI KOMBI



“Dhe për çdo komb ekziston një destinim, kështu që ata, kur t’iu vijë destinimi, jo vetëm që s’kanë me mundë me e vonue aspak por edhe nuk kanë me mundë me e shpejtue.” Kur’ani.

Fjalë aq e drejtë sa edhe e qartë kjo e Kur’anit të Shejtë, fjalë që i shtyn njerëzit e mençëm e të urtë për me u mendue. Shekujt e shumtë të kaluem e kanë vërtetue me dokumenta të vërtetën logjike, të vetëdukëshme e të shkëlqyeshme të Atij Libri, të cilit nuk i ka ndodhë shtrembnim asnjë herë “në të kaluemene ashtu sikundër nuk ka me i ndodhë edhe në ardhëshmen sado që të përparojë shkenca e të lulëzojë njerëzimi. Ai ka ka me vijue i pastër e virgjir edhe në ndër gjeneratat e ardhëshme asthu si kundër ka me vazhduë të shprehë drejtësi, urtësi e virtut deri në pambarim. Fjala e tij e fortë ka me mbajtë gjithnjë epërsin që ka mbajtë në çdo kohë, sepse ajo ka frymëzue një ligj të përjetshëm që përfshin urdhënesat e parimet logjike të dalun prej asnes së lumnueshme të Hyut, urdhënesa e parime këto që s’i pëngjanë aspak atyne që prodhohen prej mendjvet njerëzore.

Kur’ani i Shejtë asht i hyjnueshëm, i pandryshueshëm e i pandërrueshëm. Ai qendroi në çdo epokë dhe ka me vijue edhe në epokat e ardhëshme i pajtjetërsueshëm e i pandërngjyerësueshëm, i qartë e i kthjelltë si drita e diellit me të vemtin ndryshim që, ndësa drita e diellit ndriçon e nxeh vetëm planetët që vërtetir rreth e përçark tij, ai ndriçon e nxeh të gjitha botnat pa përjashtim.

Një verset i Kur’anit të Shejtë asht edhe i sipërmi. Kuptimet që komentatorët kanë mundë me i dhanë fjalëve destinim i një kombi janë të shumtë. Nuk asht vendi me i përmend këtu që të gjithë. Kemi me mjaftue vetëm me kryesorin. Ky koncept kryesor shprehet shkurtazi si vijon: një komb asht destinue me u zhdukë vetëm atëherë kur ban vepra të këqija.

Po të merret parasysh koncepti i veçantë i versetit, konstatohet se i ban shenjë fatit të keq që kishte me goditë Mekasit, të cilët, me marrëzitë e tyne, kundërshtuenë ashpërsisht kuptimet e H. Muhamedit. Ndërsa po të merret parasysh koncepti i përgjithshëm, konstatojmë me lehtësi se ai i drejtohet çdo kombi që vepron ashtu si kundër vepronin ata, të cilët, para se të pranenin Islamit, nuk njifnin asnjë kufi moraliteti e urtësije. Ata kishin braktisë çdo ligj të mirë.

Njeriu asht brumzue e trajtue në atë mënyrë që të aspirojë për me zanë vend në

histori e për me u përmend në të. Ky motif i dallueshëm i tij, ky instinkt i shfaqun në të janë vepruesët kryesorë që e nxisin të kryejë vepra mbrenda shoqnisë së tij. Por një send na tërheq vërrejtjen: fryet e vepravet të tij janë pa dyshim herë pozitive e herë negative d.m.th. herë të mirë e herë të liq. Me gjith këtë, njeriu e ka në natyrë të përpiqet për me krye diçka me sa t’i vije për dore. Janë shtytësit e mbrendshëm të tij që e bajnë për me qenë dinamik, që e nxisin për me iu përshtatë naturës dhe trupave që ekzistojn në të, të cilën ndodhen në lëvizje të përhershëm. Si përfundim, çdo njeri mundohet për me krye diçka, qoftë e randësishme as e parandësishme. Duhet vonue re mandej se njerëzit ndryshojnë simpas animevet e prijvet, instinktevet e mendjvet, arsytimevet e gjykimevet, të cilët nuk janë të njëjshëm. Njerëzit, ndonëse bashkohen ndër vija të përgjithshme, nuk janë të njëjshëm ndër vija të veçanta. Disa p.sh. janë pajue me instinkte të fortë mer arësytetime e gjykime të shëndoshë, mendje të kthjellta e të pastra, me anën e të cilatvet mund të dallojnë lehtësisht të mirën prej së keqes, ndërsa të tjerët nuk mund të vihen në këtë rrafsh, me gjithse edhe këta janë njerëz. Talentet ndryshojnë ashtu sikundër ndryshon fizionomija e jashtme e trupavet të njerëzvet. Disa kanë pasë fatin me u pajue me karaktere, morale e virtute të mirë, ndërsa disa të tjerë me vese. Të parët, me çdo send që bajnë synojnë jo vetëm të mirën egoistike, por, bashkë me këtë, edhe altruistiken, atë të mbarë shoqnisë, atë mbarë një kombi dhe, së fundi, atë të mbarë njerëzimit. Këta janë solidarë me shëshoqin, punojnë së bashku mbi vija të përgjithshme, duke mos e cene njani tjetrin. Interdipendenca shoqnore e tyne ka gjetun një naltësim, një plotësim dhe, ndër kombet e qytetnuem, një përsosuni. Ndërsa të dytët janë asish që me çdo gja që bajnë kanë për qëllim vetëm egoizmin dhe regionalizmin. Këta janë të damshëm për shoqnin, këta janë elemente turbullues, këta përkulen e këthehen lehtësisht nga të fryjë era dhe, së fundi, te këta ban çerdhen e vet çdo propagandë. Me një fjalë, këta i japin shkak dasive dhe përçanmjetvet.

Pra, në një komb ka njerëz të mirë që ecin mbi udhën e drejtë si edhe të liq që e kanë humbën udhën. Me gjith këtë, sod nuk e kemi fjalën në klasifikimin e typavet njerëzorë, sepse kjo asht një çashtëje që i përket shkencës psikologjike. Por e kemi punën me shqiptarët e sodshëm. Të mos na mbetet qejfi që po e them troç: që

të gjithë, me pak përjashtime, kemi faj kush ma pak e kush ma shumë. Por disa e kanë kapërxye fare kufinin dhe s'po dijnë se qysh me i përmbledh esphet e tyre ekstremiste. Të shtymun nga propaganda djallëzore e dredharake e armiqëvet, nga një anë, si edhe nga ambicjoni egoistik, nga tjetra, janë kah përpiqen për me zhbë kombin. Mjafton, pretendojnë ata, të mbetemi pak e të jetojnë të lumtun sesa me qenë shumë e për lumël! Njerëzit qi përbajnë këtë kategori harrojnë me bamë autokritikën, e cila kishte me i çue, pa një pa dy, drejt ligjit qi ekziston në naturë: "Peshku i madh e ha të voglin!". Me fjalët tjera, edhe po të pranohet, për një çast, se ideja e tyre asht e mirë, prap se prap kishim me përfundue se atëherë kishim me qenë ma të pasigurtë se sa sod, mbasi kishim me qenë fare pak sa s'mund t'i banim ballë kurrkujt, ndërsa popujt qi banojnë rreth nesh janë shumë ma të mbëdhenj në numur dhe kishin me na përpi. Nji pjesë tjetër e këtyne typave shkon edhe ma larg. Kjo asht e mendimit qi vetëm ata të përfitojnë, pra le të mbetet e vogël Shqipnija! Sikur martirët, qi prehen ndër thellësinat e varrevet të heshtun e të fohtë të përjetësis, t'i ndigjonin këto pretendime të mykuna t'këtyne, kishin me i mallkue në mënyrën ma të ashpër për këtë kob të zi qi po ndjellin. Pastaj, nji tufë e tretë, të për bamë këta prej disa shkrimtarësh gjysmakë, nuk ka mundur ende me e dallue se e mira e Atdheut e don qi sod të jemi ma të bashkuem se kurr dhe, me fyemjet qi i bajnë njani tjetrit, harrojnë misjonin e naltë të gazetaris dhe të shtypit. Kur këta s'kanë kuptue ende se ç'don me thanë liri shtypi, s'ka dyshim se, në vend që t'i shërbejnë, e damtojnë kombin me anën e tij. Pranej, larg prej të tillë typash qi shohin vetëm rreth qarkut të tyre të ngushtë.

Tue qenë se çështja qëndron kështu na detyrohemi të tërheqim vërejtjen e çdo shqipëtarit të ndershëm, i çdo shtrese shoqnore qoftë e i çdo ideje që të jetë, qi të ketë mendjen se sod nuk asht koha e idevet, e përçamjes dhe e dasinavet, por, përkundrazi, asht koha qi detyrohemi të bashkohemi, ashtu, me nji fjalë, koha qi të bajmë bashkimin kombëtar, tuke iu shmangë propagandës makiavelike të huej si edhe tue i lanë më nji anë interesat personale për të mirën e interesit të përgjithshëm të Kombit. Mandej, kur të kemi trajtue bashkimin

kombëtar dhe kur të kemi shpëtue Shqipnin, asht Historija ajo qi ka me i nxjerrë në shesh të metat dhe të mirat e se i cilit nesh. Pikësynimi i propagandës së huej dhe përleshja e grindja në polemika të kota shoq me shoq janë faktorët qi sjellin përfundime të këqija. Armiqtë tonë po bashkohen dhe presin rastin e volitshëm për me na grabitë lirin e fitueme mba sa e sa mundimesh, vuetjesh e flinash e na ende s'po e kuptojmë. Duhet të mbushet mendja qyp se pa bashkim nuk mund të bahet gja prej gjaje. Nuk duhet të flemë, nuk duhet ta kalojm kohën tue marrë njani tjetrin nëpër gojë; duhet të bashkohemi që të përballojmë çdo rrezik, që të mbrojmë eksistencën t'onë. Bashkimi kryhet tue dashtë njani tjetrin, tue e tolerue dhe tue e nderue. Bashkimi bahet tue u tregue qyetarë të ndershëm e solidarë njani me tjetrin, të bindun ndaj ligjëvet të Shtetit dhe të Fes. Bashkim bahet tuke iu shmangë sa ma parë e mundun vllavrasjes dhe tue e zavendësue këtë me dashni vllaznore.

Në iu nënshtrofshin propagandës së huej, la ta dimë, se na s'jemi bamë tjetër veçse me duert t'ona kemi hapun varrin t'onë, gja qi asht marrija ma e madhe e shekullit.

Tham se duhet t'i shmangemi progangandës së huej, e cila synon me na futë në vllavrasje dhe prej këndej me mundë me shëmbë eksistencën t'onë si komb. Për me përballue ktë propagandë dhe për me i u shmangë vllavrasjes asht me të vërtetë gja e vashtirë e sidomos sod, por mendojmë se me pak mund ma të madh dhe me pak ma shumë vullnet të mirë e sinqeritet, për njerëzit e mirë e të ndershëm të gjitha punët janë të lehta. Duhet pra mund e punë dhe jo fjalë të thata e tash e thana të kota. Duhet pra ta shtojmë sa ma shumë e mundun organizimin shtetnor e fetar si edhe atë ekonomikun pa të cilin asgja s'kishte me mundë me u krue. Mandej nuk duhet; iu vemë veshin atyne qi duenë me ngjallë edhe nji herë intrigat fetare e regionale, sepse, në u marrshim me këto gjana, s'kishte me pasë mundësi për me trajtue bashkimin kombëtar. Këto jo vetëm qi nuk duhet t'i ringjallim, por mos me i marrë fare nëpër gojë, sidomos në kohën e sotshme qi paraqitet shumë kritike e delikate. Le të marrim mësimë prej së kaluemes. Problemi ma i madh qi duhet të preokupojë sod, problemi qi asht i njajtë si për pleqt si për të rinjt duhet të jetë shpëtimi

i kombit. Çdo problem tjetër, qi na vjen mbas këtij, duhet të lihet për ma vonë.

Për mbrojtjen e kombit mandej s'duhet kursye asgja sado e vlefshme qi të jetë për neve: as pasunija, as talenti e as fuqija fizike. Nuk duhet t'i zajmë besë amiqëvet t'onë të djeshëm e të sotshëm, ata janë gati të njisojshëm, kanë ndërrue vetëm metodat por jo qëllimet. Qëllimi i tyne kryesor asht për me ndalue bashkimin t'onë në ji shtet shqiptar të lirë e etnik. Le ta kuptojmë. "Ujku nërron qimen e jo hujin", thotë fjala e urtë popullore.

Atëherë, vllazën, le t'i shmangemi kapërximit në një luftë civile, e cila shkakton qi, në ditën kur ka me u vendos mbi fatin e popujvet, të ndodhemi të pazotët fizikisht, ekonomikisht e politikisht për me mbrojtë të drejtat dhe lirin t'onë. Tue qenë puna kështu, ideali i çdo shqiptari duhet të jetë jo vetëm me përballue çdo armik kur ta lypi nevoja, por edhe mos me durue të bahen pazarllike e kompromise me qëllim qi Atdheut t'onë t'i shkëputet ndonji pjesë. Në shpirtin e në gjakun e çdo njanit prej nesh duhet të vlojë një ide e vetme, ideja e Shipnis etnike, tue fillue qysh prej cakut ma të largët të Kosovës në Veri e deri te caku ma i përtejtmë i Çamëris në Jugë.

Si përfundim, na detyrohemi, për në daçim me jetue, të rreshtohemi ndër rreshtat e njerëzvet të ndershëm e të virtutshëm qi kanë punue e punojnë për Shqipni tuke i braktisë ata qi duenë me na çue në greminë. Njerëzit e ndershëm lavdohen dhe prej Librit të Shejtë. Të liqt qortohen prej tij: Qe p.sh. për typrat e liq: "Dhe kur Na vendosim me rrënue ndonji qytet (për shkak të demoralizimit të tyne), porosisim udhëheqësit e atij populli (qi të bien në udhë të Zotit për të fundit herë) e kur ata ngulin këmbë e s'binden, atëherë këta e meritojnë ndëshkimin dhe Na i zhbijmë në çast". Kuptimi i versetit skjarohet si vijon: Zoti iu ka dërgue kombevet urdhna për me bamë të mira, iu ka tregue udhën e drejë nëpërmjet të profetëvet të tij. Në qoftë se i nderojnë këta urdhra, ata kanë me pasë përkrahjen e pakufishme të Zotit dhe kanë me ekzistue përjetësisht. Për ndryshe, po të jepen mbas demoralizimit, korrupsionit, alkoolit, kumarit, grindjes, përleshjes e përçamjes, ata janë gjykue për me u zhdukë. Ky asht desnimi i një kombi.

Feja na jep mësimë të kjartë qi na udhëheqin

drejt udhës së shpëtimit. Na jep mësimë konkrete mbi ngjalljen dhe mbi vdekjen e kombevet. Simbas saj, solidarësija shoqnore dhe bashkim prodhojnë gjallni, ndësa përçamja dhe ndasija shkaktojnë vdekje. Le të marim pra masa për me u bashku e me shpëtue Shqipnin prej rrezikut. Ku asht zani i Atheut, kjo asht Thirrja e Fes. Me këtë mënyrë mund të përballojmë çdo kataklyzëm. Në Kur'an të Shejtë, një kombi të bashkuem që merr masa për me mbrojtë vetveten i premtohet një kapërxim i shpejtë prej gjendjes së dobisësis për në gjendjen e naltë: qytetnore, kulturore, fetare e Atdhetare. Me fjalët të tjera, ai kalon prej një gjendjeje qi i përngjan vdekjes për në një gjendje jete e gjallnije.

H. Muhamedi (a.s.), Profeti i Madh i Zotit, e trajtoi, prej një kombi të përçam e të zhytun në vllavrasje, një komb të fortë, të bashkuem e të vllaznuem në mënyrë qi asnjë shembull tjetër në Histori nuk mund të matet me të. Le të pasojmë pra edhe na gjurmën e tij, moralet dhe virtutet e tij në daçim me jetue gjithnji në harmoni vllaznore midis shëshoqit, sepse na jemi vllazën të një gjaku dhe të një race. Nuk duhet të na ndajnë as propaganda me anë të antagonzamevet fetare e as ajo regjionalja. Nuk duhet të na ndajë as rryma antagoniste ndërmjet të të rinjvet dhe të vjetërvet e as ideologjitë e hueja.

Feja për neve ka vetëm një kuptim të qartë: ajo asht faktori qi forcon ndërgjegjen kombëtare. Ajo i urren të gjith ata njerëz qi e përdorin simbas epshit e për interesat egoistike të tyne. Ajo asht eprore mbi çdo ideologji sado e gdhendun dhe e skalitun që të jetë kjo. Urdhëron ma parë e ma dalë dashurinë e Atdheut: "Dashunija e Atdheut asht pasojë e besimit".

Duhet pra ta mbrojmë Atdheun se kështu kemi me mundë me mbajtë edhe Fen.

Si përfundim, na mund të naltësohemi dhe mund t'i mbërrimë caqet dhe qëllimet t'ona, mund t'i plotësojmë aspiratat t'ona vetëm atëherë kur të përmirësojmë vetvehtjet e shpirtnat t'onë:

"Sigurisht Zoti nuk i ndryshon konditat e një Kombi për deri sa këta të përmirësojnë atë që ndodhet në shpirtat e tyne."

"Kultura Islame", Nr. 9 (57), Maj 1944

MOS MË THONI... (POEZI)

Mos më thoni se vdiq,
Mos më thoni se nuk është më,
I miri e i bukuri i nënës,
Është në zemër tashmë.
Mos më thoni, ku e qëlluan plumbat
Nëna e di, në kraharor
Çelën bozhuret e gjakut,
si lulëkuqet në dëborë.
Mos më thoni se s'vjen më,
Do e pres te pragu i derës,
E ai do t'vij si gjithnjë,
Sikur flladi i pranverës.

Do t'vij si agimi ditës,
Zemra e nënës do t'vij,
I ndritshëm si rrezja e diellit,
Magjeps si hyjni.
Mos më thoni se jam e vetme,
Se kam mbetur fillikat,
Ai do të vij me shokë netëve,
Pushkën do e var mbi shtrat
Mos më thoni se vdiq im bir,
Ai ka rën, por nuk ka vdekur
Në udhën e lirisë për ku ishte nisur,
Duhej derdh gjak për të arritur
Secili prej tyre kishte mall për atëdhe,
Por mbi të gjitha një dëshirë
Ta zhdukin errësirën e rëndë,
Që Kosova t'jetojë e pamvarur dhe e lirë
Mos më thoni, asgjë mos më thoni,
Ai do të vij rishtas si agu i ditës,
Fshijeni lotin dhe shikoni, lartë
Ai është mbi bjeshkët e Drenicës.

Hafiz Ali Korça
Marrë nga revista "Zani i Naltë", organ i Komunitetit
Musliman Shqiptar,
Tiranë, nr. 11, Gusht 1924.

FILLUAN ABONIMET

Drita Islame është e të gjithëve, kontribuo edhe ti që të rrezatojë me ndriçimin e saj të vërtetë.

Abonohu për vitin 2025 për vetëm 2000 lekë.



Kontakt: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

Tel/Fax: +355 4 22 30 492 | 067 29 47 096

Për më tepër kontaktoni me myftininë e rrethit tuaj.